

17



# RAPORTI VJETOR 2017

[www.albsig.al](http://www.albsig.al)

---

**Adresa**

**ALBSIG sh.a**  
Rruga "George W. Bush", Nr. 10,  
Tirana, Albania

**Telefon & Fax**

Tel: +355 422 54 764  
Cel: +355 68 20 52 744

**Online**

Email: [info@albsig.al](mailto:info@albsig.al)  
Website: [www.albsig.al](http://www.albsig.al)

---

# RAPORTI VJETOR 2017

NE JU OFROJMË SHËRBIMIN ME CILËSINË MË TË LARTË



PJESË E

**KASTRATI GROUP**

---

**Adresa**

**ALBSIG sh.a**  
Rruga "George W. Bush", Nr. 10,  
Tirana, Albania



**Telefon & Fax**

Tel: +355 422 54 764  
Cel: +355 68 20 52 744



**Online**

Email: [info@albsig.al](mailto:info@albsig.al)  
Website: [www.albsig.al](http://www.albsig.al)

---

# PËRMBAJTJA

1. Informacioni rreth shoqërisë
  - 1.1 Informacion i përgjithshëm i shoqërisë.
  - 1.2.Misioni, vizioni dhe filozofia e shoqërisë
  - 1.3.Profili i shoqërisë
  - 1.4.Mesazh i drejtorit të përgjithshëm
  - 1.5.Struktura qeverisëse
2. Treguesit kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2017
  - 2.1 Informacion i përgjithshëm i tregut të sigurimeve
  - 2.2. Treguesit kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2017
3. Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2017
  - 3.1. Analiza vjetore e veprimtarisë së Albsig, 2017-ta , vit i konsolidimit të rritjes
  - 3.2. Albsig pjesë e panairëve, workshopeve dhe intershipeve sa më afër studenteve
    - 3.2.1. Albsig pjesëmarrës në Panairi Klik Expo Group 2017
    - 3.2.2. Albsig si pjesë e Kastrati group pjesëmarrës në Panairin e punës 2017
    - 3.2.3. Albsig vjen mbështetës në "Rrugen drejt Suksesit" nga Vasil Naci
  - 3.3. Aktivitetet Social-Kulturore të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig.sh.a në mbështetje të femijeve
    - 3.3.1. Albsig, në mbështetje të femijeve të policeve të vrarë në krye të detyrës.
    - 3.3.2. Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group mbështet fëmijet jetim me rastin e 100-vjetorit të "Strehes së Parë Vorfnoe"
    - 3.3.3. Albsig në mbështetje të shkrimtarëve të rinj.
  - 3.4. Albsig në mbështetje të koncerteve për zhvillimet kulturore në vend
    - 3.4.1 Albsig sponsor i koncertit "Krishtlindje në Tiranë"
    - 3.4.2 Albsig mbështet për të dytin vit koncertin e këngës qytetare shkodrane "Lule Bore"
  - 3.5. Albsig gëzon e feston festat e fundvitit.
  - 3.6. Shitjet- Online, Sigurimi i kontratës së Shëndetit në Udhëtim më i shituri në tregun virtual, në faqen e webit të shoqërisë Albsig sha.
4. Politikat e monitorimit, administrimit dhe kontrollit të rrezikut të shoqërisë
  - 4.1. Hyrje
  - 4.2. Përbushja e funksionimit të menaxhimit të riskut
  - 4.3. Politika e pranimi dhe menaxhimit të rrezikut
    - 4.3.1. Identifikimi dhe kategorizimi i rreziqeve
  - 4.4. Oregesi i riskut dhe kufijtë e tolerancës së rrezikut të miratuara
  - 4.5. Rezultate të marrjes në sigurim.
  - 4.6. Administrimi i rrezikut dhe kontrollet
  - 4.7. Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara
  - 4.8. Përfundimi
  - 4.9. Rekomandimet
5. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2015
  - 5.1. Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm
  - 5.2.Çështje të trajtuara gjatë vitit 2017
  - 5.3. Opinioni i Auditorit të Brendshëm
6. Raporti i Audituesit të Pavarur
  - 6.1.Pasqyra individuale e pozicionit financiar
  - 6.2.Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse
  - 6.3.Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital
  - 6.4.Pasqyra individuale e flukseve monetare
  - 6.5. Opinioni i audituesit të pavarur
7. Objektivat strategjike dhe vjetore

# Hyrje

- 1.1.Misioni, vizioni dhe filozofia e shoqërisë
- 1.2.Profili i shoqërisë
- 1.3.Mesazh i drejtorit të përgjithshëm
- 1.4.Struktura qeverisëse

## 1.1 Informacioni rreth shoqërisë

Albsig sh.a. ("Shoqëria") është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me vendndodhje në Shqipëri. Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas Ligjit Shqiptar nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 janar 2004.

Shoqëria operon sipas një liçense të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"), më përpara i njohur si Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve ("AMS"), për tregtimin e policave të përgjithshme të sigurimit sipas rregullave të AMF-së në territorin e Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarë aktivitetet e sigurimit të jo-jetës është marrë më datë 19 qershor 2004, ndërsa liçensa që specifikon klasat e aktiviteteteve është lëshuar më datë 10 shtator 2004 nga AMS. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pasurinë, shëndetin, dhe produkte të tjera të sigurimit jo-jetës.

Shoqëria ka 16 degë në Tiranë, Durrës, Dibër, Sarandë, Shkodër, Fier, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Gjirokastrë, Berat, Kavaje. Lushnje. Më 31 Dhjetor 2017, shoqëria punësoi gjithsej 151 punonjës dhe drejtues (më 31 Dhjetor 2016: 141).

Gjatë vitit 2007 Shoqëria filloi aktivitetin në territorin e Republikës Maqedonë nëpërmjet Albsig A.D.Shkup ("Filiali"). Filiali është 100% i zotëruar nga shoqëria e sigurimit ALBSIG sh.a. Tiranë, Shqipëri ("Shoqëria mëmë"). Filiali është regjistruar më 23 prill 2007, është vendosur dhe funksionon në Republikën e Maqedonisë. Ai është liçensuar për të ofruar 11 klasa të sigurimit të jo-jetës; megjithatë aktivitetet kryesore të tij përfshijnë ofrimin e shërbimeve të sigurimit në fushat e mjeteve motorike, pasurisë dhe ndaj aksidenteve.Me daten 21 Nentor 2017, Shoqëria Meme shiti 90% te aksioneve te filialit tek "XH & XH Teknologjia"shpk me baze ne Shkup (Republika Maqedonese ). Me 31 Dhjetor 2017 Albsig sha zoteron 10% te filialit I quajtur "Nova insurance AD Skopje, pasi blesit e rinj e ndryshuan emrin e filialit pas procedurave te kryera prane Autoritetit Mbikeqyres te Sgurimeve Maqedoni



**MUHARREM BARDHOCI**

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

*Të nderuar Miq...!*

*ALBSIG është ndër të paktat shoqëri që ka ruajtur një trend pozitiv dhe vit pas viti ka konsoliduar pozitën në tregun e sigurimeve. Sigurisht, kjo rritje e vazhdueshme vjen si rezultat i investimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme të Grupit Kastrati, por dhe te një strategjie të qartë të shoqërisë. Gjatë viteve të fundit, kemi investuar në zgjerimin e gamës së produkteve, dhe në mënyrë të veçantë në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe kujdesit ndaj klientëve.*

*Edhe përgjatë 2017, ALBSIG për të tretin vit rradhazi ka patur trendin më të lartë të rritjes. Viti që lamë pas, ka qenë viti më i sukseshëm për ALBSIG. Aktualisht pozicionohemi të dytët në treg dhe kjo sigurisht është tregues i besimit të klientëve.*

*Sigurisht, kjo rritje është dhe si rezultat i suksesit në linjat e produkteve vullnetare, sidomos në produktin Kasko, "Aksidente dhe Shëndet" si dhe Prona.*

*ALBSIG renditet e para në tregun e sigurimeve për produktin "KASKO" dhe e dyta për sigurimet vullnetare.*

*Rritja e vazhdueshme dhe konsolidimi i pozitave në tregun e sigurimeve na bëjnë më optimistë për 2018. Do të vazhdojmë të investojmë në infrastrukturë dhe cilësinë e shërbimeve dhe investojmë në kualifikimin dhe trajnimet e vazhdueshme të stafit, të rrisim nivelin e trajnimeve për linjat kryesore dhe të reja te biznesit, duke i dhënë prioritet sigurimeve vullnetare dhe kërkesave të tregut.*

*Ekspertët tanë mundësojnë konsulencë financiare të personalizuar për secilin klient qoftë individ apo kompani dhe pikërisht falë kësaj filozofie kemi ndërtuar një marrëdhënie afatgjate dhe të konsoliduar, të cilën do ta vazhdojmë dhe në të ardhmen.*

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin*

*Faleminderit.*

Z. Muharrem Bardhoci  
Drejtor i Përgjithshëm

## 1.3 Mesazh i drejtorit të përgjithshëm

## 1.1 MISIONI DHE VIZIONI



**JU KTHEN BUZËQESHJEN...!**



Rr. George W. Bush, Nr. 10, Tiranë, Albania Tel: + 355 42 254 764, E\_mail: info@albsig.al, Web: www.albsig.al



### MISIONI

Për të zhvilluar Biznesin e Sigurimeve në interesin më të mirë të komunitetit.

Për të provuar sigurinë financiare të individëve, bizneseve, duke ofruar produkte sigurimi & shërbime të kualitetit të lartë me kosto të përballueshme.

### VIZIONI

Për të qenë më të respektuar, më të besuar dhe me shërbim të standarteve më të mira në sigurimin e jo-jetës në tregjet ku operojmë.

### FILOZOFIA

Me besimin konsumator, si një themel në të gjithë aktivitetin, Albsig përpiqet në mënyrë të vazhdueshme, për të rritur vlerat dhe për të qëndruar sa më kompetitiv në treg.



## 1.2 Profili i shoqërisë



<b>Emri i shoqërisë:</b>	Alb-Siguracion sh.a.
<b>Lokalizimi i zyrave qendrore:</b>	Adresa: Rr. "George W. Bush", No. 10 - Tirana, Albania Tel: +355 4 22 54 770 Tel: +355 4 22 54 764 Fax: +355 4 2254 664 <a href="http://www.albsig.al">www.albsig.al</a>
<b>Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës:</b>	Z. Shefqet Kastrati Z. Arben Breshani Znj. Ilda Muçmataj
<b>Drejtor i Përgjithshëm:</b>	Z. Muharrem BARDHOCI
<b>Data e themelimit:</b>	09 / 01 / 2004
<b>Kapitali:</b>	879,460,000 lek
<b>Numri i punonjësve:</b>	151
<b>Biznesi kryesor:</b>	Non-life insurance



## 1.3 Struktura qeverisëse

Organet më të larta të shoqërisë Albsig sh.a janë Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës. Kompetencat e këtyre organeve drejtuese përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

### **Shoqëria Alb-Siguracion Sh.a ka këtë Strukturë Organike:**

Asambleja e Përgjithshme e aksionareve  
Këshilli mbikëqyrës

#### **Komitetet**

1. Komiteti i Administrimit të Rrezikut
2. Komiteti i Auditimit

#### **Drejtori i Përgjithshëm**

Zv/Drejtorët e Përgjithshëm

#### **Departamentet**

##### **Departamenteti i Marrjes në Sigurim të Pronës dhe Risigurimit**

- i. Sigurimi i Pronës
- ii. Sigurimi i shëndetit
- iii. Njësia e zhvillimit të produktit, inovacionit dhe marketingut
- iv. Risigurimi dhe Marrëdhëniet me jashtë

##### **Departamenteti i Marrjes në Sigurim për Produktet Motorike dhe Administrimi i Rrjetit**

- i. Sigurimi i detyrueshëm motorik (MTPL)
- ii. Marrëdhëniet me bankat & Leasing
- iii. Sigurimi Kasko, GPS
- iv. Degët

##### **Departamenteti i Dëmeve**

- i. Dëmet TPL
- ii. Dëmet e Kartonit Jeshil dhe Kasko
- iii. Dëmet e shëndetit
- iv. Njësia e investigimit
- v. Kontrolli i informacionit statistikor dhe rakordimi i dëmeve

##### **Departamenteti i Financës dhe Kontabilitetit**

- i. Njësia e Kontabilitetit
- ii. Njësia e Financës
- iii. Njësia e raportimit financiar

##### **Departamenteti i Menaxhimit të Rriskut dhe IT**

- i. Njësia e Aktuaristikës dhe Statistikës
- ii. Njësia e Teknologjisë së Informacionit
- iii. Njësia e Zbatueshmërisë/Përputhshmërisë

## **Departamenteti Juridik**

- i. Njësia e Cështjeve Administrative & AML
- ii. Proceset Gjyqësore dhe Paditë e Regresit
- iii. Njësia e Pajtueshmërisë

## **Departamenteti i Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimet Administrative**

- i. Burimet Njerëzore (HR)
- ii. Shërbimet Administrative, Protokoll & Arkivë
- iii. Sekretar/Recepsion

## **Njësia e Auditimit të Brendshëm**

Kjo strukturë e re organike është për një funksionim më të mirë dhe gjithpërfshirës të të gjithë Shoqërisë e cila paraqitet në organigramën në aneksin 1 (bashkëlidhur)

## **Kapitali i nënshkruar**

*Kapitali i paguar i shoqërisë më 31 Dhjetor 2014 është 879,460 mijë Lekë*

*Kapitali i paguar së bashku me Fitimin e mbartur me 31 Dhjetor 2016 është 1.076.126.648.*

*Veprimtari sigurimi jo-jetë, në klasat e sigurimit më poshtë:*

*Liçenca i jep të drejtën Shoqërisë së Sigurimeve Albsig Sh.a e kryerjes së operacioneve të sigurimit në cilësinë e operatorit të Jo-Jetës sipas grupeve të sigurimit të listuara më poshtë:*

- \* Grupi nr. 1 "Aksidente"*
- \* Grupi nr. 2 "Sëmundjet"*
- \* Grupi nr. 3 "Mjete tokësore" (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)*
- \* Grupi nr. 4 "Mjete lëvizëse mbi shina"*
- \* Grupi nr. 5 "Avionët"*
- \* Grupi nr. 6 "Anijet"*
- \* Grupi nr. 7 "Mallrat në transport"*
- \* Grupi nr. 8 "Zjarri dhe forcat e natyrës"*
- \* Grupi nr. 9 "Dëmtime të tjera të pasurisë"*
- \* Grupi nr. 10 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve"*
- \* Grupi nr. 11 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve"*
- \* Grupi nr. 12 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i anijeve"*
- \* Grupi nr. 13 "Përgjegjësitë civile të përgjithshme"*
- \* Grupi nr. 15 "Garancitë"*



## 2.Treguesit kryesore të aktivitetit të tregut të sigurimeve gjatë vitit 2017

### Përgjatë periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor 2017:

#### 2.1 Informacion i përgjithshëm i tregut të sigurimeve

Vitin 2017 ka prime të shkruara (sipas raportit të AMF) në vlerë prej rreth 16 194 milion lekë ose rreth 5.3 % më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

Rritja prej 23 % është për tregun Jo-Jetë, aty ku dhe ne operojmë me aktivitetin tonë. Duhet theksuar se Aktiviteti jo Jetë përbën 92% të gjithë tregut të Sigurimeve në Shqipëri për Vitin 2017.

Dëmet për vitin 2017 kanë një rritje prej rreth 16%, krahasuar me vitin 2016.

Rritja për dëmet e paguara Jo jetë është 11%.

#### Primet e Shkruara Bruto dhe Dëmet e Paguara

Grupimi sipas Llojit	Vlera (në mijë lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2016	2017		2016	2017
<b>Viti / Year</b>			<b>17/16-1</b>		
<b>Primi i Shkruar Bruto / Gross Written Premiums</b>					
Aktiviteti i Jetës / <i>Life Insurance</i>	977,851	1,204,267	23.15	6.36	7.44
Aktiviteti i Jo-Jetës	14,305,843	14,907,715	4.21	93.09	92.06
Veprimtaria e risigurimit	83,946	81,696	(2.68)	0.55	0.50
<b>TOTAL</b>	<b>15,367,640</b>	<b>16,193,678</b>	<b>5.38</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>
<b>Dëme të Paguara Bruto</b>					
Aktiviteti i Jetës / <i>Life Insurance</i>	182,324	263,680	44.62	3.83	4.78
Aktiviteti i Jo-Jetës	4,062,675	4,525,135	11.38	85.32	82.06
* Dëme dtë Paguara Fond Kompesimi	516,748	725,357	40.37	10.85	13.15
Veprimtaria e risigurimit /	-	-		-	-
<b>TOTAL</b>	<b>4,761,747</b>	<b>5,514,171</b>	<b>15.80</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

## 2.2. Treguesit kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2017

Aktiviteti i shoqërisë për vitin 2017 vlerësohet pozitiv. Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2017 çoi në konsolidimin e mëtejshëm të shoqërisë. Albsig Sh.a tashmë përfaqëson një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore.

Aktiviteti ekonomik përgjatë vitit 2017 ka shënuar progress të ndjeshëm. Është rritur prezenca e Albsig sh.a në tregun e sigurimeve jo-jetë, Të ardhurat nga Primet Vitin 2017 kapin vlerën mbi 1 953 milion lekë, kjo e kthyer në përqindje 104 % e planifikimit. Primet Krahasuar me vitin e kaluar rreth 218 milionë Lekë ose 11% më shumë.

Sipas statistikave Sigurimi detyrueshëm zë 54% të të ardhurave nga primet në Total, ndërsa sigurimet vullnetare 46%.

Pavarësisht se raporti i sigurimeve ndaj atyre të detyrueshme është i kenaqshëm në të ardhmen ngelet si detyre strategjike përmirësimi i raporteve në favor të sigurimeve vullnetare. Sigurimet vullnetarë si sig i Pasurise dhe Shendetit, sigurimi motorik kasko në krahasim me sigurimet e detyrueshme, pasi shikohet dhe një kërkesë në rritje nga Tregu për produktet vullnetare.

Megjithëse primet e këtij viti kishin rritje për 11 % krahasuar me vitin e kaluar raporti i përgjithshën të Ardhura/shpenzime paraqitet i i kënaqshëm, kjo pasqyrohet dhe në fitimin e realizuar.

Pra rritja e primeve (të ardhurave) nuk ka ndikuar në përkeqësimin e raportit të shpenzimeve.

Një analizë e shkurtër e shpenzimeve sipas zërave jep performancën e shoqërisë për vitin 2017.

Dëmet e paguara për vitin 2017 kanë një vlerë rreth 364 milione lekë rreth 20% më shumë se viti paraardhës. Në dëmet e paguara për vitin 2017 vazhdojnë të jenë akoma dëme të viteve të kaluara të zgjidhura me negociata e marrëveshje me palët përfituese. Kjo strategji e shoqërisë ka bërë që të bjerë dhe numri i padive në Gjykatë, por dhe kostot shtesë që paguhen në këto rastë si shpenzime administrative apo kamat vonesat etj.

Ne Totalin e dëmeve të paguar për vitin 2017, rreth 77 % e zene pagesat për dëmet e sigurimeve motorrike dhe 23 % e vlerës është pagesa për dëmet e Sigurimit të Shëndetit dhe atyre të Pasurisë.

Risigurimet për vitin 2017 kanë një rritje krahasuar me vitin paraprak. Vlerën më të madhe e zënë risigurimet fakultative dhe fronting si dhe Pasuria.

Kontratat me risiguresit janë me të njëjtët risigures, por rritja e primeve detyrimisht që con dhe në rritjen e detyrimit për Risiguresin.

Në vitin 2017 ka një tendencë rritje jo vetëm e produkteve vullnetare si sigurimet shëndetësor (bashkë me Aksidentet Personale) por të gjitha produktet e tjera vullnetare dhe të detyrueshme. Të ardhurat nga Shitja zë 97% të Totalit të tyre. Ndërsa të ardhurat nga Interesat dhe të ardhurat tjera janë 2%.

Në lidhje me të ardhurat nga Investimet në Depozita ka një tregues kjo të ulet duke konsideruar disa arsye, por kryesorja është që normat e interesit në Banka kanë pësuar një rënie gjatë kësaj periudhe si për monedhën Lek dhe në valutat e huaja. Fokusimi i investimeve të shoqërisë vetëm në depozita me afat me disa Banka sipas marrëveshjeve.

### 3. Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2017

- 3.1. Analiza vjetore e veprimtarisë së Albsig, 2017-ta , vit i konsolidimit të rritjes
- 3.2. Albsig pjesë e panairëve, workshopeve dhe intershipeve sa më afër studenteve
  - 3.2.1. Albsig pjesëmarrës në Panairi Klik Expo Group 2017
  - 3.2.2. Albsig si pjesë e Kastrati group pjesëmarrës në Panairin e punës 2017
  - 3.2.3. Albsig vjen mbështes në "Rrugën drejt Suksesit "nga Vasil Naci
- 3.3. Aktivitetet Social-Kulturore të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig.sh.a në mbështetje të fëmijeve
  - 3.3.1. Albsig, në mbështetje të fëmijeve të policëve të vrarë në krye të detyrës.
  - 3.3.2. Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group mbështet fëmijet jetim me rastin e 100- vjetorit të "Strehës së Parë Vorfnoe"
  - 3.3.3 Albsig në mbështetje të shkrimtarëve të rinj.
- 3.4. Albsig në mbështetje të koncerteve për zhvillimet kulturore në vend
  - 3.4.1 Albsig sponsor i koncertit "Krishtlindje në Tiranë"
  - 3.4.2 Albsig mbështet për të dytin vit koncertin e këngës qytetare shkodrane "Lule Bore"
- 3.5. Albsig gëzon e feston festat e fundvitit.
- 3.6. Shitjet- Online, Sigurimi i kontratës së Shëndetit në Udhëtim më i shituri në tregun virtual, në faqen e webit të shoqërisë Albsig sha.



3.1 Analiza vjetore e veprimtarisë së Albsig, 2017-ta, vit i rritjes intensive dhe i konsolidimit .

Viti 2017 do të mbetet një ndër vitet me të arritshme për Albsig. Albsig përvec takimeve të njëpasnjëshme jo vetëm me drejtuesit e degëve dhe të nën-degeve të shoqërisë organizon dhe analizon punën e bërë për periudha të ndryshme. Analiza shërben jo vetëm për tu njohur me punën e gjithësecilit por për të krijuar dhe bërë të mundur dhe një lloj marrëdhënie më të ngushtë me secilin prej punonjësve.

Ne saje te punes se mire planifikuese, organizuese e drejtuese, beri te mundur qe gjate ketij viti rezultatet ne shume fusha te kene nje nje rritje nga me te mirat nder vite. Ne saje te masave organizative e efektive, shoqeria Albsig sha, vleresohet si shoqeria me trendin me te larte te rritjes per 3-vitet e fundit,- tha ne fjalen e hapjes se Analizes Vjetore z. Muharrem Bardhoci, Drejtori i Pergjithshëm i Albsig sha .

Disa nga treguesit kryesore per vitin 2017 shkurtimisht si: sipas llojit te produktit te sigurimit, 46.25% te tyre e zene te ardhurat nga primet e sigurimeve vullnetare, nga 42.50% qe ishin nje vit me pare, Per produktin sigurim prone apo prime te shkruara per sigurim zjarri dhe demtime ne prone Albsig realizoi te ardhura 404,442 mije leke nga 301,202 mije leke nje vit me pare ose trendin e rritjes me te larte ose 34%, ku si treg ka rritje vetem 2.14%, Gjate gjithë vitit Albsig radhitet I dyti ne treg per kete produkt. Per produktin sigurim nga aksidentet dhe shendeti, Albsig realizoi prime te shkruara ne shumen 162,065 mije leke, nga 119, 417 mije leke qe ishte nje vit me pare, me nje rritje 35%, ku gjithë tregu pesoi rritje vetem 3.7%.

Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2017 çoi në arritje të mëtjshme të shoqërisë që përfaqëson një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore.



### 3.2. Albsig pjesë e panairove, workshopeve dhe intershiveve të studenteve

#### 3.2.1. Albsig pjesmarrës në Panairi Klik Expo Group 2017

##### Pallati i Kongreseve 23 deri me 26 Nëntor 2017

Është viti i parë që shoqëria Albsig sha merr pjesë në panairin e zhvilluar nga Klik Expo Group në datat 23 - 26 Nëntor 2017 që u zhvillua në Tiranë me edicionin e tij të 24-t të Panairit Ndërkombëtar të Tiranës, në Pallatin e Kongreseve. Panairi Ndërkombëtar i Tiranës, solli sipërmarrës, profesionistë dhe tregëtarë nga mbi 20 vende të ndryshme të botës si: Shqipëria, Italia, Greqia, Sllovenia, Mali i Zi, Bullgaria, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Austria, SHBA, Hungaria, Republika Popullore e Kinës, Kosova, Serbia, Polonia, Qiproja, Turqia, Malta etj. Aty morrën pjesë rreth 20,000 vizitorë nga të cilët 40% ishin operatorë ekonomikë, të cilët morën pjesë në takimet e biznesit të mundësuar nga formati specifik i misioneve tregtare të integruara në strukturën e panairit dhe axhendat e mirë organizuara. Sipas shifrave, Panairi Ndërkombëtar i Tiranës dëshmon të jetë një portë e sigurt dhe e besueshme për sipërmarrësit ndërkombëtarë që synojnë tregun shqiptar dhe atë të Ballkanit Perëndimor, ndërsa për sipërmarrësit lokalë bëhet rruga e kërkimit për mundësi më të favorshme për t'u internacionalizuar pa ndonjë kosto shtesë. Albsig sha u paraqit në këtë panair me stendë të vecante në të cilën bëri të mundur reklamimin jo vetëm të produkteve dhe shërbimeve por dhe të një stafi të kualifikuar të specialistëve të departamenteve të shitjes. Albsig sha mbështet me pjesmarrjen e saj nismat e reja përmes panairove të zhvilluara në fushat e ndryshme të sigurimeve.



### 3.2.2 Albsig si pjese e Kastrati group pjesëmarrës në Panairin e punës 2017

Në ambientet e Pallatit të Kongreseve në Tiranë është mbajtur Panairi i Punës 2017, i cili qëndroi i hapur nga data 29 deri më 31 mars 2017. Në këtë panair mori pjesë dhe shoqëria Albsig si pjesë e Kastrati Group.

Panairi i punës u cilësua si një burim i rëndësishëm informacioni për të kuptuar se çfarë ndodh me tregun e punës. Dhjetëra kompani të ndryshme që veprojnë në Shqipëri në këtë panair që organizohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ishin në kërkim të ofertave të tyre për punësim për tre ditë me radhë. Edhe shoqëria Albsig sha bëri të mundur kërkesat momentale për vendet vakante për mundësinë e punësimit të të rinjve.

Përgjatë tre ditëve të panairit në stendën e Kastrati Group duke përfshirë këtu dhe Albsig sha u dorëzuan mbi 150 kërkesa punësimi për në departamentet e ndryshme të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig. Pas rishikimeve të CV dhe ritestimeve të të rinjve që u interesuan për punë gjatë panairit, u bë e mundur marrja e tyre në punë sidomos në sektorin e shitjeve pranë shoqërisë Albsig sha.



### 3.2.3 Albsig vjen mbështes në "Rrugën drejt Suksesit" nga Vasil Naci

9 Nëntor 2017 gjatë eventit unik që organizohet në Pallatin e Kongreseve nën drejtimin e Z. Vasil Naçi, njëri prej sipërmarrësve më të suksesshëm në Shqipëri dhe rajon, Albsig u bë sponsor mbështetës i ideve dhe trajnimit që bëri ky sipërmarrës. Ku ka më mirë se të nisesh Rugëtimin Drejt Suksesit duke marrë pjesë në eventin që mbledh njerëzit më pozitivë në Shqipëri e më tej?

Zgjidh të marrësh pjesë e të përfitosh jo vetëm nga mësimet që jepen aty por edhe nga energjia fantastike që krijohet mes pjesëmarrësve dhe e rëndësishme është që kjo energji të kthehet në një burim dhe të tejkohet te të tjeret, më shumë pozitivitet më shumë angazhim me shume harmoni ku është çelisi i suksesit..



#### GOLDEN PARTNERS



#### SILVER PARTNERS



### 3.3 Aktivitetet Social-Kulturore të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig.sh.a në mbështetje të fëmijeve.

ALBSIG.sh.a , edhe për vitin 2017 ka ndjekur të njëjtin fokus dhe ecuri të viteve të mëparshme duke krijuar tashmë një traditë e cila do të vijë duke u forcuar në të ardhmen. Shoqëria , është gjithmonë në përpjekje për të përmbushur rolin e saj social, përmes operimit me përgjegjësinë më të lartë: duke suportuar klientët në çdo hap dhe duke u dhënë zgjidhje problemeve, duke forcuar raportet me të gjithë rrethin e bashkëpunëtorëve që operojnë në të njëjtën industri dhe mbi të gjitha, duke përmirësuar cilësinë e jetës në komunitetin ku jetojmë dhe punojmë të cilën shoqëria e quan të rëndësishme . Përmes programeve dhe nismave të ndërmarra synojmë përfshirjen e komunitetit në aktivitetet e organizuara, në sfera të ndryshme të jetës sociale.

Përgjegjësitë sociale janë pjesë e strategjisë së shoqërisë Albsig sha si dhe politikave të saj, duke synuar krijimin e vlerave të larta morale për shoqërinë e punonjësit, si dhe për të kontribuar në qën drueshmërinë dhe përmirësimin e kushteve sociale dhe mjedisore të komunitetit në të gjithë vendin.

#### 3.3.1 Albsig, në mbështetje të fëmijeve të policëve të vrarë në krye të detyrës.

Me rastin e festave të fundvitit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, organizon një aktivitet festiv për fëmijët dhe familjarët e punonjësve të Policisë të rënë në krye të detyrës.

Në evenimentin e fundvitit organizuar për policët e rënë në krye të detyrës si mbështetëse e nismës së tillë humanitare ishte dhe shoqëria Albsig.sh,a pjesë e Kastrati Group. Në vigjilje të ndërrimit të viteve 2017-2018, përkatësisht në fund të muajit Dhjetor Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako ishin pranë këtyre familjeve dhe fëmijëve të policëve të vrarë në krye të detyrës.

Eventi i realizuar për fëmijët u mbështet nga një grup biznesesh ku një ndër to është dhe Albsig.sh.a. Nën atmosferën festive të krijuar nga 'Albanianrobots' u bë dhe shpërndarja e pakove me dhurata të ofruara nga kompani dhe organizata për familjarët dhe fëmijët e të rënëve të policëve në krye të detyrës. Po ashtu për 60 fëmijë u shpërndanë nga 20.000 lek , si dhe për 225 familje të Dëshmorëve të Policisë u shpërndanë nga 10.000 lek, kontribut më së shumti i vetë punonjësve të Policisë së Shtetit, për familjet e kolegëve të tyre.





### 3.3.2 Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group mbështet fëmijet jetim me rastin e 100-vjetorit të "Strehës së Parë Vorfnore"

Në aktivitetin "Java e Fëmijëve Jetimë në Presidencë" me rastin e 100 Vjetorit të "Strehës së Parë Vorfnore" 1917-2017 mori pjesë dhe shoqëria Albsig sha.

Mes miqve artistë dhe shumë personaliteteve të fushave të ndryshme, pjesmarrës nga Komuniteti Fetar, e Trupat Diplomatike ishte i pranishëm presidenti i Kastrati group i portretizuar si humanist dhe bamirës i cili, gjithmonë ka qënë dhe është në përkrahje të shtresave në nevojë të shoqërisë e vecanerisht të fëmijëve jetimë.

Braktisja e fëmijëve nga prindrit si dhe fëmijet e mbetur jetim si pasojë e aksidenteve apo dhe fatkeqësive të tjera vazhdon të jetë një problem shqetësues për shoqërinë shqiptare.

Albsig.sh.a. si pjesë e Kastrati Group ka qënë dhe është mbështetje e nismave në ndihmë të fëmijëve jetim. Numërohen disa aktivitete në mbeshtetje ndër vite për fëmijët jetimë të shtëpisë së fëmijës "Zyber Hallulli" në Tiranë.

Numërohen afro 100 familje brenda Kastrati-Group duke përfshirë këtu Albsig por edhe jashtë tij që janë mbështetur duke i punësuar fëmijët e tyre vetem nga fakti që këta të fundit vijnë nga familje me një prind ose pa asnjë.



### 3.3.3 Albsig në mbështetje të shkrimtarëve të rinj.

Në kuadër të mbështetjes së zhvillimit të mëtejshëm të artit dhe kulturës shoqërore Albsig thuhet për çdo vit mbështet si sponsor shkrimtarët e rinj. Në arkivat e Albsig numërohen më shumë se 250 vepra letrare që vetëm falshoqërisë është bërë e mundur shtypja dhe botimi i tyre.

Këtë vit ndryshe nga vitet e tjera shoqëria Albsig shpall mbështetje të shkrimtarin dibran Z. Sakip Cami me librin e tij të fundit mbi hulumtimet që ai ka bërë në zonën e Dibrës për heronjtë e padëgjuar të asaj zone. Hulumtime historike dhe faktet reale të pathënë ndonjëherë do të jenë ekskluzive në librin e ri i cili del në treg në këtë periudhë.



### 3.4. Albsig në mbështetje të koncerteve për zhvillimet kulturore në vend

#### 3.4.1 Albsig sponsor i koncertit “Krishtlindje në Tiranë”


Albsig sponsor mbështetës i koncertit madhështor, tashmë traditë prej vitesh i titulluar “Krishtëlindje në Tiranë”. Ky koncert me shumë surpriza dhe risi në edicionin e tij të tretë në prezantimin e producentit dhe regjisorit Sokol Guga është përkrahur nga shume ndjekës.

Tashmë i kthyer në traditën e Krishtlindjeve në Tiranë është mbajtur një natë madhështore në Akademinë e Arteve në mbrëmjen e 24 Dhjetorit. “Krishtëlindje në Tiranë” mbështetur nga Albsig sh.a pjesë e Kastrati Group, për herë të parë si një ndër sponsorat kryesorë ka bërë të mundur rikthimin e prezantueses historike Silvana Braçe e cilësuar si një divë e ekranit e cila prezantoi këtë spektakël për të dytën herë.

Danilo Zeka, primo-balerini shqiptar me famë në Greqi është një tjetër artist i ftuar atë mbrëmje që na surprizon në skenë, por jo vetëm kaq,

Mihai Traistariu, këngëtar i famshëm në Rumaninë në Euro Song ishte gjithashtu një tjetër i ftuar që shkeli në skenën e spektaklit.

Këngëtarja Kejsi Tola, baritoni Armando Likaj, grupi All in Band dhe Neritan Liçaj ishin gjithashtu disa prej emrave pjesë e spektaklit. “Krishtlindje në Tiranë”, një spektakël ku luhet dhe përformohet live me 50 instrumentist virtuoz. Një tjetër surprizë që produksioni i spektaklit bëri këtë vit ishte ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga që natën magjike realizoi një intervistë ekskluzive në skenë me moderatoren Silvana Braçe.



### 3.4.2 Albsig mbështet për të dytin vit koncertin e këngës qytetare shkodrane "Lule Bore"

Festivali i Këngës Qytetare Shkodrane, rikthyer një vit më parë në traditë, këtë vit solli edhe më shumë shkëlqim. 22 këngë të reja, iu shtuan fondit të mrekullueshëm të këngës popullore dhe asaj të kultivuar shkodrane, e sigurisht subjekt mbetet dashuria e përjetshme e krijuesve shkodrane, për qytetin e tyre.

Dirigjenti Jetmir Barbullushi e përshkruan këtë si "një eksperiencë të jashtëzakonshme të realizuar pas një pune të jashtëzakonshme."

Me çmim të parë u vlerësua kënga "Me ty u rrit kanga shkodrane" kompozuar nga Edmond Zhulali, me tekst të Agim Doçit, interpretuar nga Myfarete Laze. Ndonëse çmimet e vlerësimet e kanë shoqëruar gjatë gjithë karrierës, Myfarete Laze, këtë çmim e priti me emocion të veçantë:

Myfarete Laze u shpreh: "Festivali i Këngës Qytetare Shkodrane është një festival që bëhet me shumë dashuri çdo vit. Mund të them se jam gëzuar pamasë për këtë çmim dhe u jam shumë mirnjohëse."

"Festivali" Lulebore" ishte një gërshetim brezash krijuesish e interpretuesish, të cilët sollën vlera të padiskutueshme. Çmimi i dytë shkoi për Lidia Lufin dhe përkatësisht çmimi i tretë iu dha Blerta Cinës dhe grupit "Kajrafilat që ka Shkodra".

"Festivali Lulebore" festivali i këngës qytetare shkodrane është një kontribut i çmuar për ruajtjen dhe trashëgimin e vlerave më të mira të muzikës qytetare shkodrane, të gjitha këngët pjesmarrëse u regjistruan nga Radio Televizioni Shqiptar dhe për vitin e dytë radhazi po mbështetet nga shoqëria Albsig sha si një ndër sponsorat kryesore të këtij eventi.

Albsig ka mbështetur dhe do mbështes gjithmonë brezat në vazhdim për të zhvilluar e rikujtuar sa më shumë brezat e kënetarëve në vite.



### 3.5. Albsig gëzon e feston

Festat e fundvitit priten me emocione të medha sepse normalisht i lënë vendin gjërave negative që mund të kemi kaluar dhe i hapin dritaren një rrezeje të re dritë pozitive.

Urimi më i bukur për këto festa është që t'ia kalojmë bukur dhe të qëndrojmë gjithmonë të bashkuar pranë familjareve e miqve tanë të dashur dhe të jemi sa më transparentë dhe korrekt me shërbimet tona ndaj klientëve. Shëndet dhe sa më shumë mbarësi, lumturi e begati. Kudo të mbizotërojë paqja, harmonia dhe dashuria. Gëzuar!!!”


Me këtë mesazh përshendetës dhe motivues Zv.Presidenti i Kastrati Group z.Leonard Kastrati përshëndeti stafin e KastratiGroup në të cilin përfshihet dhe Albsig.sh.a si nje ndër bizneset më të suksesshme.

Shoqëria e sigurimeve Albsig.sh.a pjesë e Kastrati Group, e cila operon në tregun sigurimeve në Shqipëri, ka vazhduar traditën duke organizuar festat e fundvitit dhe duke falenderuar punonjësit për përkushtimin në punë dhe korrektësi, transparencë dhe besueshmëri në tregun e sigurimeve.

Normalisht, kur flasim për festat e fundvitit i referohemi Krishlindjeve dhe Vitit të Ri, dy festa të bukura me të cilat ne mbyllim një vit dhe presim ardhjen e një viti të Ri.

Në shoqërinë e Sigurimeve Albsig festa e fund vitit bën të mundur gërshetimin e tradicionales me modernen. Punonjësit janë ata që ndajnë më shumë atmosferën e ngrohtë të festave dhe mbështetjen e drejtuesve të shoqërisë në evente të tilla sociale. Tashmë është bërë traditë e përvitshme që Albsig ndan dhurata dhe çmimet speciale për punonjësit sipas performances që ata kanë shpalosur në punë përgjatë një viti kalendarik që lamë pas.

Fotot ilustruese per festat e fundvitit



3.6 Shitjet- Online”, Sigurimi i kontrates se Shëndetit në Udhëtim më i shituri ne tregun virtual, ne faqen e webit te shoqerise Albsig sha.

Revolucioni në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit ka ndryshuar jo vetëm jetën tonë por edhe mënyrën se si njerëzit bëjnë biznes.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë dhe aplikimi i saj po e bën jetën shumë dinamike, sidomos jetën e bizneseve. Interneti ka krijuar një mundësi për përparimin e bizneseve duke punuar në një treg më të gjerë, duke zvogluar kostot, duke rritur efikasitetin e tyre, duke plotësuar nevojat konsumatore si dhe duke rritur bashkëpunimin me partnerët dhe konkurentët e tyre .

Kohën e fundit Albsig.sh.a ka ngritur rrjetin e shitjeve online qe funksionon falë ndihmës së internetit, respektivisht presencës dhe shitjeve online.

Duke e pasur parasysh zhvillimin teknologjikë, përkatsishtë mundësia e ofrimit të shitjeve online, u pa e domosdoshme per shoqerine per krijimin e rrjetit te produkteve me te kerkuara per konsumatorët ne shitjet online.

Kerkesat per shitjen ne tregun online sa vijne e shtohen.

Sjellja e konsumatorëve online ndryshon (në disa aspekte të rëndësishme) nga sjellja e konsumatorëve në tregun tradicional.

Termi biznes elektronik paraqitet si proces i blerjes, shitjes, transferit apo kërkimit të produkteve, shërbimeve dhe informatave përmes internetit apo rrjeteve tjera kompjuterike. Aktualisht rrjeti i shitjeve online për Albsig përmban një numër të konsiderueshem produktesh.

Produktet e servitura përmes rrjetit të shitjeve online në Albsig janë produktet si:

Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim,ky i fundit është cilësuar dhe me i shituri deri tani, Sigurimi nga Zjarri dhe Rreziqet Shtesë (pronë, banesë, apartamente),

Sigurimi i Shëndetit Individual, njëkohësisht dhe duke mos lënë pa përmendur dhe Sigurimin e Detyrueshëm TPL.

The screenshot shows the Albsig website interface. At the top, there is a red navigation bar with the Albsig logo, the Kastrati Group logo, and contact information including a phone number (+355 4 2254764) and a search bar. Below the navigation bar, a main banner features a photograph of a smiling woman and child. The banner text reads 'SIGURIM SHËNDETI' with a 'MË TEPËR' button. To the right of the banner are three red buttons: 'SHITJET ONLINE MË TEPËR', 'RAPORTIM I DËMIT ONLINE MË TEPËR', and 'CHAT ONLINE MË TEPËR'. Below the banner, the text 'PRODUKTET TONA' is visible. At the bottom of the page, there is a Windows activation notice and a system tray showing the time as 9:30 AM on 6/20/2018.

#### 4. Politikat e monitorimit, administrimit dhe kontrollit të rrezikut të shoqërisë

##### 4.1. Hyrje

##### 4.2 Përmbushja e funksionimit të menaxhimit të riskut

###### 4.2.1 Identifikimi dhe kategorizimi i rreziqeve

##### 4.3 Politika e pranimit dhe menaxhimit të rrezikut

###### 4.3.1 Identifikimi dhe kategorizimi i rreziqeve

##### 4.4. Oreksi i riskut dhe kufijtë e tolerancës së rrezikut të miratuara

##### 4.5. Rezultate të marrjes në sigurim.

##### 4.6 Administrimi i rrezikut dhe kontrollet

##### 4.7. Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara

##### 4.8. Përfundimi

##### 4.9. Rekomandimet



## 4.1 Hyrje

Raporti Vjetor për vlerësimin e rreziqeve paraqet rezultatet kryesore në procesin dhe metodologjinë e vlerësimit të rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet shoqëria e sigurimit; supozimet bazë të përdorura për kryerjen e provave të rezistencës dhe rezultatet e tyre; vlerësimin e ushtrimit të përgjegjësive nga ana e strukturave përkatëse për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e rrezikut; rekomandimet e parashtruara, masat ndreqëse të përcaktuara në bazë të rekomandimeve, dhe nivelin e zbatimit të tyre; si dhe nivelin minimal të kapitalit në raport me profilin e rrezikut.

Raporti vjetor përmban të paktën informacionin e kërkuar, në nivel shoqërie sigurimi dhe/ose grupi, dhe të shpjeguar si më poshtë:

Qëllimi të përcaktojë parimet minimale mbi bazën e të cilave shoqëria e sigurimit ndërton sistemin e administrimit të rrezikut, si dhe harton tërësinë e politikave dhe proceseve që lidhen me përcaktimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e rreziqeve.

Shoqëria e sigurimit dokumenton çdo fazë dhe veprim të procesit të vlerësimit të rrezikut dhe të kryerjes së provave të rezistencës, në formë të tillë që përdoruesi i dokumentacionit të arrijë në të njëjtat përfundime. Shoqëria e sigurimit paraqet brenda datës 31 maj të çdo viti në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare raportin vjetor mbi vlerësimin e rreziqeve të shoqërisë dhe kryerjes së provave të rezistencës.

## 4.2. Përmbushja e funksionimit të menaxhimit të riskut

Strategjia e Menaxhimit jep një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar, për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun.

Strategjia e Menaxhimit synon të ndërtojë dhe të nxisë zhvillimin duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve.

Menaxhimi i riskut është një proces i vazhdueshëm, që është përdorur në zbatimin e strategjisë së biznesit dhe lejon për një kuptim të duhur të natyrës dhe rëndësisë së rreziqeve, ndaj të cilave biznesi është i ekspozuar, duke përfshirë edhe ndjeshmërinë ndaj këtyre rreziqeve dhe aftësinë e tij për të zbutur ato.

Duhet të sigurohet se ekziston një qasje e koordinuar dhe e integruar e menaxhimit të rrezikut në një gjuhë të përbashkët të rrezikut, që kuptohet në të gjithë biznesin.

Keshilli Mbiqyrës është në fund përgjegjës për të siguruar efektivitetin e sistemit të menaxhimit të rrezikut, përcaktimin e oreksit të rrezikut dhe kufizimet e përgjithshme të tolerancës së rrezikut, si dhe miratimin e strategjive kryesore të menaxhimit të riskut dhe politikave të përkatëse.

Komiteti i Administrimit të rrezikut luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin sa më mirë të riskut nëpërmjet departamenteve.





### 4.3 Politika e pranimit dhe menaxhimit të rrezikut

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot financiare në minimumin e domosdoshëm.

Menaxhimi i riskut lidhet me rreziqet dhe mundësitë që ndikojnë në krijimin e vlerave ose ruajtjen e vlerave të përcaktuara si më poshtë:

**"Menaxhimi i administrimit të rrezikut është një proces i ndikuar nga drejtuesit e njësisë, menaxherët dhe pjesa tjetër e stafit, i projektuar për të identifikuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë impakt në shoqëri si dhe menaxhuar riskun për ta mbajtur brenda kufijve të oreksit për arritjen e objektivave të shoqërisë"**

Strategjia është ndërtuar mbështetur në disa parime thelbësore që përcakton dhe menaxhimin e riskut, në drejtimet si vijon:

Menaxhimi i Riskut krijon dhe mbron vlerat;  
Menaxhimi i Riskut është pjesë integrale e proceseve të shoqërisë;  
Menaxhimi i Riskut është pjesë e vendimmarrjes;  
Menaxhimi i Riskut i adresohet pasigurisë;  
Menaxhimi i Riskut është sistematik, i strukturuar dhe në kohë;  
Menaxhimi i Riskut bazohet në informacionin më të saktë të mundshëm;  
Menaxhimi i Riskut merr në konsideratë faktorët njerëzor dhe kulturor;  
Menaxhimi i Riskut është transparent dhe përfshirës;  
Menaxhimi i Riskut është dinamik, interaktiv dhe reagues ndaj ndryshimeve; dhe  
Menaxhimi i Riskut lehtëson përmirësimin e vazhdueshëm të shoqërisë.

Përkufizimit të fushave të riskut dhe të detyrave delikate në veprimtarinë e shoqërisë Albsig sh.a.,

#### 4.2.1 Identifikimi dhe kategorizimi i rreziqeve

Në Planin e menaxhimit të rrezikut identifikimi i rreziqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim të gjitha rreziqeve të rëndësishme me të cilat përballlet shoqëria.

Shoqëria fokusohet tek rreziqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjike.

Këto rreziqe janë pjesë e procesit të administrimit të rrezikut.

Pjesë e procesit të administrimit të rrezikut janë dhe rreziqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme.

Shoqëria ka identifikuar si rreziqe kryesore ku dhe ka orientuar skenarët e stresit si më poshtë:

- Rreziku i sigurimit
- Rreziku i kreditit
- Rreziku i tregut
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku operacional
- Rreziku strategjik

Këto janë rreziqet kryesore që mund të kërcënojnë objektivat strategjike të shoqërisë, por ka dhe rreziqe të tjera si:

- Rreziku i këmbimit të monedhës së huaj
- Rreziku reputacional
- Rreziku i cmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, në vecanti TPL.

Rreziqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuara më poshtë:

## i) Rreziku i Kreditit

Rreziku i kreditit i referohet rrezikut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kur pranohen primet fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguruarve. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut nga fondet e mbajtura, depozitat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedurë të brendshme për risigurimet dhe rreziku është i monitoruar nga personat përgjegjës për risigurimet. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave.

Informacione shpjeguese shtesë për primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit janë si më poshtë:

	2017						2016	
	Primet e ceduara		Aktivet e risigurimit		Primet e ceduara		Aktivet e risigurimit	
	'000 Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit
<b>Norma</b>								
AA	963	0.59%	531	0.59%	963	0.85%	327	0.85%
A+	118,330	71.90%	66,264	73.00%	76,541	67.73%	26,012	67.73%
A	21,912	13.31%	11,085	12.21%	21,912	19.39%	7,297	19.00%
A-	11,660	7.09%	6,431	7.09%	11,660	10.32%	4,113	10.71%
AA-	11,704	7.11%	6,455	7.11%	1,934	1.71%	657	1.71%
BB	-	-	-	-	-	-	-	-
Pa normë	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>164,569</b>	<b>100.00%</b>	<b>90,767</b>	<b>100.00%</b>	<b>113,010</b>	<b>100.00%</b>	<b>38,406</b>	<b>100.00%</b>

Rreziku i kreditit lidhet kryesisht me risigurimin, duke qenë se shoqëria, pavarësisht cedimit të rreziqeve tek risiguruesi ka detyrimin ndaj klientëve edhe nëse risiguruesit falimentojnë.

### ii) Rreziku i Tregut

Rreziku i tregut për shoqërinë lidhet kryesisht me faktorë të tregut financiar, si normat e interesit dhe kurset e këmbimit, apo faktorë të jashtëm, si ecuria ekonomike, si dhe humbje nga portofoli i investimeve.

### iii) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normave të interesit është i ndikuar nga rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli rreziku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe rreziku i shkaktimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

### iv) Rreziku i këmbimit të monedhës së huaj

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEKË, USD dhe EURO). Flukset monetare nga të ardhurat nga primet janë burimi kryesor i fondeve për depozitat me afat në valutë të huaj. Rreziku i këmbimit të monedhës së huaj lind nga lëvizjet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj. Ekspozimi ndaj këtij rreziku kryesisht lind gjatë një periudhe në të cilën shoqëria ka një pozicion të hapur si në bilanc dhe jashtë bilancit dhe/ose me kursin aktual ose të ardhshëm të tregut. Është kryer analizë sasiore e rrezikut valutor të shoqërisë më 31 dhjetor 2017. Ndikimi i luhatjeve të kurseve të këmbimit është reflektuar për vitin e mbyllur 2017.



## v) Rreziku Operacional

Rreziku operacional lind nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollet e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmëria dhe katastrofat natyrore.

- Përdorimi më efikasitet i sistemit të shitjes, administrimit dhe dëmeve ka minimizuar shumë risqe duke bërë të mundur një harmonim më të mirë midis kontrollit dhe raportimit.
- Rëndësi e madhe i është dhënë pagesës së dëmeve, duke e konsideruar një marketing për shoqerine. Pagesa e dëmit në një periudhë të shkurtër është një praktikë, e cila ndiqet deri në lajmërimin e klientit që vlera e dëmit të rënë dakord nga klienti ka kaluar në llogarinë e tyre dhe ka ndikuar në performancën e shoqërisë.
- Analizat aktuariale ndikojnë në aplikimin e metodave më të mira aktuariale për llogaritjen e provigjoneve të dëmeve (IBNR) dhe për kontrolle më të forta mbi të dhënat nga Aktuari, sidomos të dëmeve shëndetësore të TPL, të cilat kanë luhajte në vlerësime. Për këtë Departamenti i Dëmeve bashkëpunon me Departamentin Juridik dhe Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe IT për marrjen e informacionit të plotë dhe në kohë për të gjitha rastet e ndodhura të dëmeve për tu raportuar saktë për efekt të provigjoneve teknike të dëmeve si dhe azhurnimi i dëmeve në proces gjyqësor me vendimet e gjykatave në periudhat që raportohen dhe në zbatim të "Procedura për trajtimin e dëmeve sipas statuseve të tyre dhe rakordimi ndërmjet departamenteve përkatëse". Testimi i provigjonimit të dëmeve është bërë nëpërmjet analizës RUN-OFF të dëmeve. Kjo analizë është bërë për dëmet e ndodhura dhe të raportuara (RBNS) në shoqëri dhe për dëmet e ndodhura dhe nuk janë të raportuara (IBNR). Teste për vlerësimin e provigjoneve të dëmeve në 31.12.2016 për sigurimin e detyrueshëm motorik TPL, Karton jeshil, Kufitare dhe Kasko janë bërë në mënyrë të vazhdueshme në periudhat në vazhdim duke marrë rezultate positive. Megjithatë rezultate positive janë marrë për IBNR, që për rredhojë sjell rezultat pozitiv të totalit. Si më poshtë po japim një rezultat për MTPL, Kartonin jeshil dhe Kaskon që zënë dhe peshën kryesore në provigjonet e dëmeve total.

## RUN-OFF 2016

		MTPL	KARTONI JESHIL	KASKO
	<b>Run-off Analysis of RBNS (Lek)</b>			
a	RBNS 2016	83,700,913	374,776	7,043,572
b	Claims paid 2017, reported before 2017	44,251,957	206,393	5,400,257
c	RBNS 2017 for claims reported before 2017	62,323,171	190,878	3,704,488
	<b>Run-off result</b>	<b>(22,874,215)</b>	<b>(22,495)</b>	<b>(2,061,173)</b>
	<b>Run-off %</b>	<b>-27%</b>	<b>-6%</b>	<b>-29%</b>

	<b>Run-off Analysis of IBNR (Lek)</b>			
a	IBNR 2016	121,676,742	371,787	15,835,537
b	Claims reported in 2017 and paid in 2017, incurred before 2017	21,533,479	20,390	5,597,084
c	Claims reported in 2017 in RBNS 2017, incurred before 2017	6,966,338	273,900	-
	<b>Run-off result</b>	<b>93,176,925</b>	<b>77,497</b>	<b>10,238,453</b>
	<b>Run-off %</b>	<b>77%</b>	<b>21%</b>	<b>65%</b>

	<b>Run-off Analysis of IBNR (Lek)</b>			
a	Claim reserve 2016	205,377,655	746,563	22,879,109
b	Claims paid 2017, reported before 2017	44,251,957	206,393	5,400,257
c	Claims reported in 2017 and paid in 2017, incurred before 2017	21,533,479	20,390	5,597,084
d	Claims reported in 2017 in RBNS 2017, incurred before 2017	6,966,338	273,900	-

Departamenti i Burimeve njerëzore të shoqërisë bën një punë efektive në përzgjedhjen profesionistëve në sigurime, agjentëve me një cilësi sa më të mirë në shërbimin ndaj klientit duke iu referuar gjithmonë misionit kryesor të shoqërisë.

Klienti në vizionin e shoqërisë sonë është i pari dhe shërbimi ndaj tij duhet të marrë një vlerë, e cila na bën konkures në treg. Politikat e komunikimit dhe ato të motivimit të punonjësve luajnë një rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin e burimeve njerëzore të shoqërisë Albsig sh.a.

## ix) Rreziku i Sigurimit

Rreziku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit

Rreziku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësi

- Shoqëria ka miratuar "Procedura dhe politika të brëndshme lidhur me verifikimin e përputhshmërisë me politikat e marrjes në sigurim dhe sistemet e tarifimit të tyre".Keto politika jane ne ndryshim te vazhdueshem ne pershtatje me tregun, rregullatoret per te vendosur nje standart me te larte ne menaxhimin e risqeve ne nivel shoqerie.
- Shoqëria ka miratuar urdhërin për nivelin e kompetencave të marrjes në sigurim të produkteve vullnetare për shumat e sigurimit. Kufizimet janë të vendosura nga sistemi i shitjes dhe administrimit.Ky nivel kompetencash eshte gjithmone i monitoruar dhe i ndryshueshem ne pershtatje me tregun, rregullatoret per te vendosur nje standart me te larte ne menaxhimin e risqeve ne nivel shoqerie
- Shoqëria ka miratuar udhëzimin për "Procedurat e policave të anuluar, publikatave dhe zgjidhjes së kontratave.Keto procedura rishikohen dhe pershtaten duke pase ne focus risqet dhe menaxhimin sa me te mire te tyre.
- Aktiviteti i marrjes në sigurim në shoqëri mbikqyret nga menaxher të nivelit të lartë, por aktiviteti i marrjes në sigurim është i ndarë në njësi të vecanta operative që mbikqyret nga menaxherët sipas linjave të vecanta të sigurimit. Ne marrjen në sigurim në shoqëri përgjegjesitë e biznesit që përmbajnë rrisht të larta janë të mbikëqyrura nga menaxhere me nivel të lartë profesional.
- Shoqeria gjithmone investon ne permiresimin e Sistemit te shitjes dhe administrimit te kontratave te sigurimit duke e pare me prioritet dhe rendesine qe ka mirefunksionimi i ketij sistemi per riskun operacional kjo ben qe te monitorohet duke vendosur procedura të forta të shitjes së kontratave të sigurimit si me poshte:

Propozim të primeve dhe tarifave të produkteve nga sistemi duke mos lejuar shitjen në këto prime pa marrë miratimin e personave përgjegjës.(nivel kompetencash e shkruar dhe bllokuese ne sistemin e shitjes )

Kufizime për shumat e sigurimit tek policat vullnetare sipas kompetencave.(nivel kompetencash)

Kufizim në shitje të llojit te policave sipas userave te shitjes.

Parametizim të policës së sigurimit sipas kompetencave etj.

Shitja në kohë reale pothuajse e të gjithë produkteve.

Procedurë e fortë për anulimin, publikatën dhe kthimin policave të sigurimit etj.

Në strukturën organizative të shoqërisë ka menaxhim të mirë të njërive të marrjes në sigurim sipas linjave të sigurimit dhe përfshirja e njësisë së administrimit të kontratave te sigurimit.

Njësia e administrimit të kontratave te sigurimit në cdo periudhë raporton dhe në bashkëpunim me njësitë e marrjes në sigurim sipas linjave të sigurimit kryejnë një kontroll rigoroz të policave fizike për të qenë në përputhje me kushtet e marrjes në sigurim.

Kontratat e sigurimit fizike mbi 10% e Aftësisë Paguese kontrollohen edhe pranë Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut dhe IT. Në momentin e marrjes së informacioneve shtesë për policat e sigurimit shoqëria bën rishikim të kufijve të marrjes në sigurim.

Gjithashtu nga personat përgjgjës kryhen kontrole ditore/periodike në kohë reale nëpërmjet sistemit të shitjes së policave, që policat e shitura të jenë në përputhje me kushtet e kontratave të sigurimit.

Kur identifikohet që ka mangësi ose gabime në plotësimin e policës së sigurimit, këto raste raportohen në personat përkatës për t'u rregulluar.

Përsa i përket rrezikut të marrjes në sigurim sistemi i shitjes ka një rol të rëndësishëm dhe një kontroll në nivele ku çdo punonjës apo përdorues ka limitet e veta deri në finalizimin e marrjes në sigurim. Për produktin kasko, garanci oferte, garanci kontrate etj me anë të sistemit të shitjes kontrollohen të gjithë agjentët të cilët kanë akses për të marrë në sigurim këto produkte dhe është përgjegjësi i këtyre produkteve që i monitoron dhe u miraton një vlerë më të madhe se e lejuara me anë të sistemit, tarifat preferenciale duke krijuar një historik të veprimeve deri në finalizimin përfundimtar të marrjes në sigurim. Shoqeria Albsig ka gjithmone ne fokus permiresimin e sistemit te shitjes dhe administrimit.Ky system eshte gjithmone ne ndryshim per tu pershtatur sa me mire me nevojat e shoqerise dhe me perdoruesit e tij.

Shume permiresime ne lidhje me sistemin e shitjes dhe administrimit jane finalizuar dhe te tjera jane ne proces per tu finalizuar ne te ardhmen.

## ix) Rreziku i Sigurimit

Rreziku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit

Rreziku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësi

- Shoqëria ka miratuar "Procedura dhe politika të brëndshme lidhur me verifikimin e përputhshmërisë me politikat e marrjes në sigurim dhe sistemet e tarifimit të tyre". Keto politika janë në ndryshim të vazhdueshëm në pershtatje me tregun, rregullatoret për të vendosur një standart me të lartë në menaxhimin e risqeve në nivel shoqërie.
- Shoqëria ka miratuar urdhërin për nivelin e kompetencave të marrjes në sigurim të produkteve vullnetare për shumat e sigurimit. Kufizimet janë të vendosura nga sistemi i shitjes dhe administrimit. Ky nivel kompetencash është gjithmone i monitoruar dhe i ndryshueshëm në pershtatje me tregun, rregullatoret për të vendosur një standart me të lartë në menaxhimin e risqeve në nivel shoqërie
- Shoqëria ka miratuar udhëzimin për "Procedurat e policave të anuluar, publikatave dhe zgjidhjes së kontratave. Keto procedura rishikohen dhe pershtaten duke pasqyruar fokusin në risqet dhe menaxhimin sa më të mirë të tyre.
- Aktiviteti i marrjes në sigurim në shoqëri mbikqyret nga menaxherët të nivelit të lartë, por aktiviteti i marrjes në sigurim është i ndarë në njësi të vecanta operative që mbikqyret nga menaxherët sipas linjave të vecanta të sigurimit. Në marrjen në sigurim në shoqëri përgjegjësitë e biznesit që përmbajnë rrisht të larta janë të mbikëqyrura nga menaxherët me nivel të lartë profesional.
- Shoqëria gjithmone investon në përmirësimin e Sistemit të shitjes dhe administrimit të kontratave të sigurimit duke e parë me prioritet dhe rëndësi që ka mires funksionimi i këtij sistemi për riskun operacional kjo ben që të monitorohet duke vendosur procedura të forta të shitjes së kontratave të sigurimit si më poshtë:

Propozim të primeve dhe tarifave të produkteve nga sistemi duke mos lejuar shitjen në këto prime pa marrë miratimin e personave përgjegjës. (nivel kompetencash e shkruar dhe bllokues në sistemin e shitjes)

Kufizime për shumat e sigurimit tek policat vullnetare sipas kompetencave. (nivel kompetencash)

Kufizim në shitje të llojit të policave sipas userave të shitjes.

Parametizim të policës së sigurimit sipas kompetencave etj.

Shitja në kohë reale pothuajse e të gjithë produkteve.

Procedurë e fortë për anulimin, publikatën dhe kthimin policave të sigurimit etj.

Në strukturën organizative të shoqërisë ka menaxhim të mirë të njësive të marrjes në sigurim sipas linjave të sigurimit dhe përfshirja e njësive të administrimit të kontratave të sigurimit.

Njësia e administrimit të kontratave të sigurimit në çdo periudhë raporton dhe në bashkëpunim me njësitet e marrjes në sigurim sipas linjave të sigurimit kryejnë një kontroll rigoroz të policave fizike për të qenë në përputhje me kushtet e marrjes në sigurim.

Kontratat e sigurimit fizike mbi 10% e Aftësisë Paguese kontrollohen edhe pranë Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut dhe IT. Në momentin e marrjes së informacioneve shtesë për policat e sigurimit shoqëria bën rishikim të kufijve të marrjes në sigurim.

Gjithashtu nga personat përgjegjës kryhen kontrole ditore/periodike në kohë reale nëpërmjet sistemit të shitjes së policave, që policat e shitura të jenë në përputhje me kushtet e kontratave të sigurimit.

Kur identifikohet që ka mangësi ose gabime në plotësimin e policës së sigurimit, këto raste raportohen në personat përkatës për t'u rregulluar.

Përsa i përket rrezikut të marrjes në sigurim sistemi i shitjes ka një rol të rëndësishëm dhe një kontroll në nivele ku çdo punonjës apo përdorues ka limitet e veta deri në finalizimin e marrjes në sigurim. Për produktin kasko, garanci oferte, garanci kontrate etj me anë të sistemit të shitjes kontrollohen të gjithë agjentët të cilët kanë akses për të marrë në sigurim këto produkte dhe është përgjegjësi i këtyre produkteve që i monitoron dhe u miraton një vlerë më të madhe se e lejuara me anë të sistemit, tarifat preferenciale duke krijuar një historik të veprimeve deri në finalizimin përfundimtar të marrjes në sigurim. Shoqëria Albsig ka gjithmone në fokus përmirësimin e sistemit të shitjes dhe administrimit. Ky sistem është gjithmone në ndryshim për tu pershtatur sa më mirë me nevojat e shoqërisë dhe me përdoruesit e tij.

Shume përmirësime në lidhje me sistemin e shitjes dhe administrimit janë finalizuar dhe të tjera janë në proces për tu finalizuar në të ardhmen.

4.5 Rezultate të marrjes në sigurim.

Duke u bazuar në një analizë 5-vjecare 2013-2017 dhe tek testi i rezultateve të marrjes në sigurim sipas portofoleve si më poshtë për 2017:

Albsig	Liability Adequacy Test 2017	Aksidente dhe Shëndeti	Kasko	Sigurimi i detyrueshëm	Prona	Pergjegjësitë	Garancitë	Total
a	Gross Ëritten Premiums	162,089,874	191,569,018	1,045,937,364	405,743,730	69,129,457	78,639,835	1,953,109,277
b	R/I premium less R/I commissions		2,361,395	26,053,078	118,976,678	17,177,887		164,569,038
c=a-b	Net Ëritten	162,089,874	189,207,623	1,019,884,286	286,767,051	51,951,570	78,639,835	1,788,540,238
d	Gross UPR 31-12-2017	25,546,166	102,567,448	483,954,917	246,402,839	42,994,370	46,980,486	948,446,227
e	Gross UPR 31-12-2016	41,153,918	92,992,548	483,253,845	157,158,482	47,448,584	37,171,622	859,178,999
f	R/I UPR 31-12-2017		4,371	50,924	75,920,478	14,790,985		90,766,758
g	R/I UPR 31-12-2016		3,787	47,312	23,717,582	14,636,942		38,405,623
h=d-e-f+g	Change in UPR net	13,982,096	9,574,317	697,461	37,041,461	-4,608,257	9,808,863	66,495,942
i=c-h	Net earned premiums	148,107,777	179,633,306	1,019,186,825	249,725,590	56,559,827	68,830,972	1,722,044,297
h	Claims Paid	27,523,186	75,150,892	182,039,597	54,872,281		378864	339,964,820
i	Claims Paid from R/I							0
j=h-i	Claims Paid Net	27,523,186	75,150,892	205,822,600	54,872,281		378864	363,747,823
k	Gross Claims reserve 31-12-2017	12,827,845	35,279,792	458,741,584	5,793,369		1,924,858	514,567,448
l	Gross Claims reserve 31-12-2016	5,122,199	22,879,109	318,836,310	6,181,043		1,775,966	354,794,628
m	R/I claims reserve 31-12-2017			26,590,000				26590000
n	R/I claims reserve 31-12-2016							0
o=k-l-m+n	Change in loss reserve (net of R/I)	7,705,646	12,400,683	113,315,274	-387,674	-	148,892	133,182,821
p	Acquisition costs	63,592,650	65,060,736	314,919,234	103,076,488	16,447,232	16,681,470	579,777,809
q	Other Expenses	38,358,359	18,607,643	334,689,486	74,541,143	33,344,815	47,006,148	546,547,595
r=j+o+p+q	Expenses	91,080,459	171,219,954	836,963,507	232,102,238	49,792,048	64,215,374	1,445,373,580
s=r/i	Technical result	10,927,938	8,413,351	50,440,230	17,623,353	6,767,779	4,615,598	98,788,249
	Rap.i shpenzime të marrjes në sigurim	43%	36%	31%	41%	29%	24%	34%
	Raporti deme prime neto	24%	49%	31%	22%	0%	1%	29%
	Raporti shpenzimeve	69%	47%	64%	71%	88%	93%	65%
	Raporti i kombinuar	93%	95%	95%	93%	88%	93%	94%
	URR							

Duke u bazuar në rezultatet e portofoleve sipas testit të mjaftueshmërisë së provigjioneve për primin e pafituar të mësipërm arrijmë në përfundimet:

- Portofoli i Aksidenteve dhe shëndeteve ka tendencë në rritje të raporteve dëme/prime neto nga 12% në 2016 në 24% në 2017.

Ky portofol ka raport tepër të lartë të shpenzimeve, jashtë diapazonit normal edhe pse krahasuar me vitin 2016 ka ulje nga 82% në 69%.

Ky raport vazhdon të monitorohet me kujdes në të gjitha elementet përbërëse të tij nga menaxherët e marrjes në sigurim të këtij portofoli që të jetë në normat e duhura.

- Produkti Kasko është në përgjithësi produkt me risk shumë të lartë që do menaxhuar me shumë kujdes. Nga analiza për këtë produkt shihet që ka tendencë në ulje të raportit të shpenzimeve nga 2016 në 2017 dhe rritje të raportit dëme/prime neto.

Eshte bere e ditur per menaxherët e këtij produkti për tamonitoruar me me kujdes

Ne menyre te tille qe ky raport në të gjitha elementet përbërëse të tij, te mos rezultojë me humbje.

Gjithashtu shume analiza jane kryer gjatë vitit, analiza totale për produktin dhe në nivel subjekti te siguruar.

- Sigurimi i detyrueshëm motorik përgjatë 5 viteve të fundit ruan pothuajse të njëjtin nivel të raportit të shpenzimeve të marrjes në sigurim por kanë rritje në totalin e shpenzimeve nga 60% në 64%, por që është mbi diapazonin normal të këtij raporti.

Raporti dëme / prime neto 3 vitet e fundit është në të njëjtat nivele tek 31%.

Edhe për sigurimin e detyrueshëm motorik u eshte rekomanduar menaxherëve të marrjes në sigurim të këtyre produkteve që ta monitorojne me kujdes këtë raport që te vijë në normat e lejuara.

- Portofoli i Pronës (Zjarr dhe rreziqe shtesë, Mall gjatë transportit, Vjedhja, Sigurimi inxhinierik) nga analiza del që e ka tepër të lartë raportin e shpenzimeve jashtë diapazonit normal edhe pse rezulton me ulje nga viti 2016 ndërsa raporti dëme / prime neto ka rritje nga 2016.

Për këtë arsye ky raport vazhdon të monitorohet me kujdes nga menaxherët e marrjes në sigurim që të jetë në normat e duhura.

- Sigurimi i Përgjegjësive civile në ndryshim nga viti 2016 paraqet raport më të ulët të shpenzimeve të marrjes në sigurim nga 63% në 29%, por në nivelin e shpenzimeve totale mbetet në të njëjtat nivele.

Ky produkt vazhdon të monitorohet me kujdes në të gjithë elementet e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve të tjera të jetë në normat e duhura.

- Sigurimi i garancive të Ofertës dhe Kontratës ka rritje të raportit të shpenzimeve dhe të raportit të kombinuar në 2017 duke u krahasuar me vitin 2016.

Ky produkt po monitorohet me kujdes në të gjithë elementet e shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe shpenzimeve të të jetë në normat e duhura.

Teste të rezultateve sipas linjave të sigurimit janë bërë në mënyrë periodike nga të cilat është vërejtur se është përmissuar raporti i shpenzimeve administrative dhe për linja të vecanta edhe raporti i shpenzimeve të marrjes në sigurim.

Raporti i kombinuar është ruajtur thajse në të njëjtin nivel me vitin 2016.

Paraqitja e rreziqeve më sipër shërben për kategorizimin e skenarëve të rrezikut, të cilët më tej ndahen në nënklasa.



### 4.5.1 Toleranca dhe kufijtë e rrezikut

Toleranca ndaj rrezikut përcaktohet nga objektivat strategjike të shoqërisë. Objektivat strategjike të shoqërisë janë të lidhura kryesisht me objektivat e rritjes në treg, marzhet e synuara të fitimit dhe mbajtjen e një niveli kapitali mbi një marzh të caktuar. Në këto objektiva është përcaktuar si qëllimi i pozicionimit në treg në pjesmarje, ashtu dhe në raport me cilësinë e shërbimit.

Matësit e nivelit të rrezikut që përdoren kryesisht janë kufijtë gjatë procesit të marrjes në sigurim, si për ekspozimet individuale ashtu dhe për ekspozimet agregate sipas linjave të sigurimit.

Shoqëria ka manual dhe procedura të hartuara për këtë qëllim. Shoqëria është në proces ndertimi të një manuali të ri i cili do të jetë një ndihmese e madhe në të ardhmen.

Shoqëria zbaton marrëveshje risigurimi treaty, fakultative në mbrojtje të kapitalit.

Një nga rreziqet më të rëndësishme të matshme nga ana sasiore, ndaj të cilit mund të përdoren strategjitë e zbutjes është vlerësuar rreziku i katastrofave.

Shoqëria Albsig sh.a., është në proces të rishikimit dhe ndertimit të politikave të ndryshme të cilat janë cituar dhe në planin e menaxhimit të riskut të miratuar në keshillin mbikëqyrës të shoqërisë.

Primet nga biznesi i Pronës vijnë në mënyrë vullnetare dhe nga kanalet bankare (mbi 70% e primeve të shkruara bruto në portofolin e pronës janë si kërkesa të bankës për kolaterale).

Zbutja e këtij rreziku kryhet nëpërmjet risigurimit, si mekanizmi kryesor i transferimit të këtij rreziku, pasi rreziqet bazë për produktin Zjarri dhe rreziqe shtesë me përfitues bankat e nivelit të dytë ka Zjarr dhe Tërmet.

### 4.6 Administrimi i rrezikut dhe kontrollet

Shoqëria sipas programit të administrimit të rrezikut nuk fokusohet vetëm tek rreziqet kryesore, por dhe tek rreziqe që mund të kenë ndikime serioze në rast materializimi.

Modeli i administrimit të rrezikut në shoqërinë Albsig Sh.a është konceptuar në përputhje me modelin e "tre linjave të mbrojtjes", që janë:

Linja e parë e mbrojtjes: Këtu përfshihen njësitë e biznesit sipas përgjegjësive që ato kanë. Linja e parë e mbrojtjes përbën linjën e parë të vendimmarrësve në nivel operacional dhe janë përgjegjës për vendimet që marrin dhe proceset që operojnë, në përputhje me politikën, manualin dhe procedurat e shoqërisë.

Linja e dytë e mbrojtjes: Këtu përfshihen funksionet mbikëqyrëse si Komiteti i Administrimit të Rrezikut dhe Komitete të tjera, pra janë funksione të kontrollit. Këto funksione këshillojnë linjën e parë, që është përgjegjëse për vendimet operacionale. Linja e dytë kontrollon grupin e rreziqeve, por nuk është përgjegjëse. Linja e dytë këshillon për metodologjitë e përshtatshme për zbutjen e rreziqeve ose ndihmojnë për vlerësimin sasior dhe për shkallëzimin e rreziqeve.

Linja e tretë e mbrojtjes: Këtu përfshihen funksioni i auditit të brendshëm me njësinë e auditit të brendshëm që kryen kontrole të pavarura dhe raporton në Këshillin Mbikëqyrës. Linja e tretë nuk ka përgjegjësi për administrimin e rreziqeve dhe vendimmarrje operacionale. Linja e tretë vlerëson në mënyrë të pavarur për të dhënë siguri mbi procesin e administrimit të rreziqeve. Jep rekomandime se si përmisohen proceset e administrimit të rreziqeve. Kjo linjë përforcohet edhe nga auditimi i jashtëm i pavarur. Pra:

- Linja e parë e mbrojtjes përbëhet nga njësitë e biznesit dhe ka përgjegjësinë kryesore në procesin e administrimit të rreziqeve.
- Linja e dytë e mbrojtjes që përbëhet nga funksionet e kontrollit: Administrimi i rrezikut, Pajtueshmëria, Aktuaristika monitoron dhe kontrollon proceset e administrimit të rreziqeve.
- Linja e tretë e mbrojtjes që përbëhet nga Auditimi i brendshëm, Auditimi i jashtëm shqyrton në mënyrë të pavarur proceset e administrimit të rreziqeve.

#### 4.6.1 Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese

Shoqëria ka objektiv kryesor që niveli i kapitalit që do mbajë do të jetë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Shoqëria do ruajë një nivel marzhi 250% ndaj kufirit minimal të kërkuar të kapitalit, sipas metodës me bazë primet ose dëmet, si dhe do synojë gradualisht dhe mbajtjen e një niveli të paktën 150% të fondit të garancisë.

Kjo strategji do të jetë ruajtja e kërkesave rregullatore në cdo kohë, përdorimi eficient i kapitalit, nëpërmjet analizës së vazhdueshme të treguesve të performancës. Duke patur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi për nivelin e kapitalit është testuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet skenarëve të stresit, për të bërë të mundur zbutjen e rreziqeve që dobësojnë fuqinë e kapitalit. Shoqëria ka testuar, duke bërë provën e rezistencës mbi bazën e shumës së sigurura, pasi nuk ka të dhëna publike në lidhje me probabilitetet dhe dëmet e ndodhura nga katastrofat natyrore në vendin tonë. Në fund të vitit 2017 vlera e fondit të garancisë është brenda të gjitha normave të kërkuara.

#### 4.7 Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara

Plani i vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara vlerësohen nga shoqëria Albsig sh.a si një rrezik, i cili duhet administruar me shumë kujdes, nisur nga varësia ndaj sistemeve të IT. Shoqëria i jep rëndësi këtij rreziku, sepse në rastin e një katastrofe duhet të garantojë vazhdimësinë operacionale të saj dhe ti përgjigjet në kohë dhe shpejtësi kërkesave të klientëve për dëmshpërblim. Shoqëria e ka në objektivin e saj për përmisime cilësore të mëtejshme.

E rëndesishme është për të qene në monitorim të qëndrueshëm për të gjitha fushat e rrezikut.

Për këtë shoqëria është gjithmone fokusuar në ndërmarrjen e masave për eliminimin apo pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm.

Shoqëria gjithmone ka një parim se menaxhimi i Riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qene në ekuilibër me njëri tjetrin.

Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se një risku të vetëm duke bërë të vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm.

Shoqëria është e fokusuar në një raportim efektiv të informacionit kyç të rrezikut të qeverisjes për të siguruar që personat e përfshirë të kenë të gjithë informacionin e nevojshëm për të marrë në konsideratë në procesin e vendimmarrjes.

Një punë nga shoqëria është dhe ngritja e nivelit të ndergjegjesimit të punonjesve në përgjithësi dhe në veçanti me ceshtjet që janë të lidhura me menaxhimin e riskut. Kjo me anë të seminareve, trajnimeve etj.

Tokio Marine Holding Co., Ltd.

#### 4.8. Përfundimi

Nga procesi i vetëvlerësimit të përcaktuar më sipër arrihet në përfundimin që shoqëria ka një nivel të menaxhueshëm të rreziqeve. Shoqëria është në përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar në të gjitha drejtimet ku operon duke krijuar një standart të lartë në të ardhmen.

#### 4.9. Rekomandimet

Nga vlerësimi i strukturës së shoqërisë dhe efikasitetit të saj për të zbatuar planin e administrimit të rrezikut dhe për të qenë në përputje me ligjislacionin në fuqi rezulton se struktura e administrimit të rrezikut në shoqëri të integrohet në nivel operacional dhe të mbikëqyret nga drejtuesit me ata të pavarur. Gjithashtu kërkohet një rol më aktiv i komiteteve për të rritur cilësinë e monitorimit dhe përgjegjshmërinë nga Këshilli Mbikëqyrës. Rreziqet kryesore të trajtuara më lart do të jenë në fokus edhe për vitin 2018.

*To Be a Good Company*

INTEGRATED ANNUAL REPORT 2017

## 5. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2017

### 5.1. Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm

#### 5.2. Çështje të trajtuara gjatë vitit 2017

#### 5.3. Opinioni i Auditorit të Brendshëm

Auditimi i Brendshëm ka kryer angazhimet e tij për vitin 2017 fokusuar në çështjet e klasifikuara me prioritet të lartë dhe me prioritet të mesëm sipas Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2017, aprovuar nga Këshilli Mbikqyrës, me vendim Nr. 08, datë 30.12.2016.

### 5.1 Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Kartën e Auditimit të Brendshëm, kerkesat e rregullores "Për Veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit" miratuar me vendimin e Bordit nr. 153, datë 23.12.2014 dhe praktikat me të mira ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të rekomanduara nga Instituti Ndërkombëtar i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm ka bazuar planifikim e tij për angazhimet që ka ndërmarrë mbi bazën e risqeve me të cilat përballet shoqëria, duke përzgjedhur veprimtaritë me kyçe, me impakt të lartë dhe me ekspozim të konsiderueshëm ndaj tyre.

Auditimi i brendshëm nuk ka pasur konflikte interesi dhe ka qenë i pavarur dhe i pandikuar nga ndërhyrje për mënyrën e organizimit si dhe nga çdo ndërhyrje në lidhje me përcaktimin e qëllimit, procedurave, shpeshësisë së kontrollit, apo përmbajtjen e raportit të auditimit.

## 5.2 Çështje të trajtuara gjatë vitit 2017

Sipas Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2017, janë kryer angazhime në aktivitetet dhe proceset kyçe të shoqërisë, sipas prioritetit të tyre. Disa nga çështjet e trajtuara ishin:

### 6.2.1 Raportimi financiar dhe kontabiliteti:

Gjatë vitit 2017 janë rishikuar përputhshmëria, plotësia dhe saktësia e raportimeve financiare nga Departamenti i Fianacës. Si rezultat i procedurave të auditimit të kryera, nuk janë evidentuar problematika ose gjetje madhore me impakt të lartë për Shoqërinë. Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet e tij për këtë proces.

### 5.2.2 Marrja në sigurim:

Objektivi kryesor i këtij auditimi ishte kontrolli dhe verifikimi i praktikave të policave të anuluar, dublikatave dhe zgjidhjes së kontratave (kthimet e primeve), në zbatim të udhëzimeve dhe procedurave të marrjes në sigurim të miratuar, me fokus respektimin e afateve të lëna, pajisjen me njoftim kërkesës, miratimet sipas kopetencave si dhe përlogaritjet e veçanta. Si rezultat i procedurave të kryera të auditimit, nuk janë evidentuar problematika ose gjetje madhore me impakt të lartë për Shoqërinë. Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet e tij për dokumentimin e proceseve dhe raportimet për manaxhimin e policave të anuluar, dublikatave dhe kthimet e primit të policave në rast zgjidhje kontrate.

### 5.2.3 Trajtimi i Dëmeve:

Krahas rishikimit të përmbushjes së rekomandimeve të mëparshme të dhëna për trajtimin e dëmeve, në objektivat e kontrolleve të ushtruara kanë qenë procese që lidhen me admimistrimin e dosjeve të dëmeve, me rishikimin e arritjes së përputhshmërisë me kërkesat dhe rregulloret e AMF për raportimin dhe dokumentacionin si dhe me procesin e procesimit të dëmeve në përgjithësi (pranimi dhe proçesimi, vlerësimi dhe shqyrtimi i dëmeve, marreveshjet dhe mbyllja e praktikave të dëmeve brenda afateve të percaktuara.

Në terma të përgjithshme, auditimi i brendshëm, pas monitorimit të ecurisë për Departamentin e Dëmeve, raporton një progres të mirë në përmbushjen e rekomandimeve të mëparshme si dhe në përmirësimin e kontrolleve të brendshme përsa i përket administrimit dhe trajtimit të dëmeve.

### 5.2.4 Menaxhimi i riskut:

Krahas rishikimit të përmbushjes së rekomandimeve të mëparshme të dhëna për menaxhimin përsa i përket përmirësimit të kontrolleve të brendshme për menaxhimin e rrezikut, objektivat e kontrollit lidhen me rishikimin e politikave të shkruara, manualeve dhe rregulloreve të brendshme, rishikimin e roleve dhe përshkrimeve të punës, tools-et, raportimet dhe aktivitetet e menaxhimit dhe administrimit të rrezikut.

Në terma të përgjithshme, auditimi i brendshëm, pas monitorimit të ecurisë për Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe IT, raporton një progres në përmbushjen e rekomandimeve të mëparshme dhe ka sugjeruar elementë për t'u ndjekur në vazhdimësi për mire-funksionimin e procesit të menaxhimit të rrezikut.

### 5.2.5 Risigurimet:

Objektivat e këtij angazhimi ishin: rishikimi i përputhshmërisë me rregulloren Nr. 85/1, datë 30.09.2015, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 88, datë 27.06.2016 të AMF-së, (i) rishikimi i politikave të shkruara, manualeve dhe rregulloreve të brendshme; (ii) rishikimi i roleve dhe përshkrimeve të punës; (iii) tools-et, raportimet dhe aktivitetet e menaxhimit dhe administrimit të rrezikut për kontratat e risigurimit. Si rezultat i procedurave të kryera, nuk janë evidentuar problematika ose gjetje madhore me impakt të lartë për Shoqërinë. Për përmirësimin në nivele më të larta, Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet e tij për këtë proces.

### 5.2.6 Menaxhimi i aseteve të shoqërisë:

Gjatë vitit 2017 janë rishikuar procedurat e administrimit të aktiveve afatgjata, procedurat e regjistrimit të aktiveve afatgjata në sistemin financiar alpha, procedurat e transferimeve të aktiveve afatgjata, procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve afatgjata, rakordimi i aktiveve afatgjata fizike me regjistrimet në sistem si dhe verifikimi fizik i aktiveve të caktuara afatgjata. Si rezultat i procedurave të kryera, nuk janë evidentuar problematika ose gjetje madhore me impakt të lartë për Shoqërinë. Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet e tij për dokumentimin e proceseve dhe raportimet për menaxhimin e aktiveve afatgjata të shoqërisë.

### 5.3 Opinion i Auditorit të Brendshëm

Si rezultat i kryerjes së aktiviteteve të auditimit të brendshëm, për vitin 2017, përveç çfarë është raportuar vazhdimisht për tematika të veçanta për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse dhe janë në ndjekje të vazhdueshme për ecurinë e tyre, nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale të cilat të kenë një impakt domethënës në aktivitetin e Shoqërisë.

Për çdo angazhim të auditimit të brendshëm janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procedurave, administrimin e informacionit dhe dokumentave si dhe proceseve të ndryshme fokusuar në risk si dhe është monitoruar niveli i realizimit të tyre.

Në mbyllje të procedurave të auditimit për vitin 2017 është vërejtur një nivel i kënaqshëm i kontrolleve të brendshme (qeverisja e Shoqërisë).

#### Auditimi i Brendshëm

---



6. Raporti i Audituesit të Pavarur

6.1.Pasqyra individuale e pozicionit financiar

6.2.Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse

6.3.Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

6.4.Pasqyra individuale e flukseve monetare

6.5.Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale

6.6.Skedule suplementare




**ALB - SIGURACION sh.a.****Pasqyra financiare më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR****më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Aktivet</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	11	56,051,532	37,168,812
Investime	6	1,385,748,721	1,007,910,330
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	8	134,016,818	109,603,479
Aktive të lidhura me risigurimin	7	117,356,758	38,405,623
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	112,157,448	72,840,098
Parapagim tatim mbi fitimin	28	-	17,458,056
Borxh i varur në filial		-	101,422,500
Aktive të tjera	9	61,884,301	54,145,129
Aktive të mbajtura për shitje	12	182,443,846	-
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	24	307,101,288	261,355,633
Aktive afat-gjata materiale	4	441,381,124	368,016,140
Aktive afat-gjata jomateriale	5	4,583,553	6,051,894
Aksione në shoqëri të lidhura	13	43,093,733	437,018,400
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>2,845,819,122</b>	<b>2,511,396,094</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali i nënshkruar	14	879,460,000	879,460,000
Fitimi i akumuluar		196,667,646	103,628,795
Fitimi i periudhes		85,390,539	93,038,851
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>		<b>1,161,518,185</b>	<b>1,076,127,646</b>
<b>Detyrimet</b>			
Rezervat teknike për dëmet	15	514,567,431	354,794,627
Rezervat e primit të pafitur	16	978,036,075	859,178,999
Llogari të pagueshme për risigurimet	17	40,468,787	39,430,875
Detyrime ndaj paleve të lidhura	18	51,709,282	39,006,283
Tatim fitimi i pagueshëm		3,549,918	-
Detyrime të tjera	19	95,969,444	142,857,664
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,684,300,937</b>	<b>1,453,805,625</b>
<b>Total i detyrimeve dhe kapitalit aksionar</b>		<b>2,845,819,122</b>	<b>2,511,396,094</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 27 prill 2018 dhe janë firmosur nga:

  
Z. Muharrem Bardhoci  
Drejtor i Përgjithshëm

  
Z. Irfan Lami  
Drejtor i Finances

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 42 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.



**ALB - SIGURACION sh.a.**  
**Pasqyra financiare më 31 dhjetor 2017**

*(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE**  
**për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	
Prime të shkruara bruto	20	1,953,109,277	1,735,277,040
Ndryshimi në rezervën e primit të pafituar	16	(118,857,076)	(218,421,949)
<b>Të ardhurat bruto nga primet e sigurimit</b>		<b>1,834,252,201</b>	<b>1,516,855,091</b>
Prime të ceduara në risigurim	21	(164,569,038)	(113,010,193)
Ndryshimi në rezervën e primit të risiguruesit		52,361,135	11,610,877
<b>Primet e fituara neto</b>		<b>1,722,044,298</b>	<b>1,415,455,775</b>
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	22	24,004,547	15,508,896
Të ardhura nga interesi	23	9,830,032	9,668,305
Te ardhura te tjera		4,083,003	11,764,340
<b>Të ardhura të tjera</b>		<b>37,917,582</b>	<b>36,941,541</b>
<b>Të ardhurat neto</b>		<b>1,759,961,880</b>	<b>1,452,397,317</b>
Dëmet të pagura të sigurimit	15	(363,747,823)	(289,655,805)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të sigurimit dhe risigurimit		(133,182,804)	(66,747,293)
<b>Dëme të sigurimit neto</b>		<b>(496,930,627)</b>	<b>(356,403,098)</b>
Kostot e marrjes në sigurim	24	(579,780,929)	(469,752,991)
Shpenzimet administrative	26	(331,636,822)	(242,398,905)
Ndryshimi në taksën e shtyrë të primit		-	(18,395,257)
Shpenzime të tjera të sigurimit	25	(112,718,039)	(238,242,742)
Shpenzime financiare, neto	27	(33,034,826)	(8,953,792)
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>		<b>(1,057,170,616)</b>	<b>(977,743,687)</b>
Humbje nga shitja e aksioneve	13	(91,715,574)	-
Humbje në ndryshimin e vlerës së mbartur të aksioneve në shoqeri te lidhura	13	(3,474,343)	-
Humbje nga shitja e aktiveve material afatgjata		(522,726)	-
<b>Fitimi i vitit para tatimit</b>		<b>110,147,994</b>	<b>118,250,531</b>
Tatim fitimi	27	(24,757,455)	(25,211,680)
<b>Fitimi i vitit pas tatimit</b>		<b>85,390,539</b>	<b>93,038,851</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>85,390,539</b>	<b>93,038,851</b>

*Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri ne faqen 42 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.*

**ALB - SIGURACION sh.a.**  
**Pasqyra financiare më 31 dhjetor 2017**

*(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**  
**më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali Aksionar	Rezerva e katastrofës	Rezerva te tjera kapitali	Fitimi i mbartur	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2016</b>	<b>879,460,000</b>	-	-	<b>103,628,795</b>	<b>983,088,795</b>
Dividendi i deklaruar	-	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	93,038,851	93,038,851
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>93,038,851</b>	<b>93,038,851</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>879,460,000</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>196,667,646</b>	<b>1,076,127,646</b>
Dividendi i deklaruar	-	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	85,390,539	85,390,539
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>85,390,539</b>	<b>85,390,539</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>879,460,000</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>282,058,185</b>	<b>1,161,518,185</b>

*Politikat kontabel dhe Shënimet nga faqja 5 deri ne faqen 42 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.*

**ALB - SIGURACION sh.a.**

**Shënime të pasqyrave financiare më 31 dhjetor 2017**

*(Të gjitha shumat janë në Lek, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

**PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË**

**më 31 dhjetor 2017**

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operative</b>		
<b>Fitimi neto para tatimit</b>	<b>110,147,994</b>	<b>118,250,531</b>
Rregullime për zërat jo-monetare në fitim ose humbje:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5 27,630,905	25,079,129
Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve materiale e jo-materiale	1,009,825	641,398
Zhvleresim i te arketushmeve	5,134,589	13,844,682
Të ardhurat nga interesi	23 (9,830,032)	(9,668,305)
Shpenzime interesi	3,665,652	2,858,783
Humbje në ndryshimin e vlerës së mbartur të interest të mbetur në filial	3,474,343	-
Humbje nga shitja e aksioneve të filialit	91,715,574	-
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve ne kapitalin qarkullues</b>	<b>232,948,850</b>	<b>151,006,218</b>
<b>Ndryshimet në:</b>		
Llogaritë e arkëtueshme bruto nga sigurimi	(71,469,861)	(40,406,342)
Aktive të lidhura me risigurimin	(78,951,135)	2,421,563
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	(45,745,655)	(70,440,255)
Taksa e primit te shtyre	-	18,395,257
Aktive të tjera	(7,739,172)	(52,033,416)
Llogari të pagueshme për sigurimet, risigurimet	1,037,912	21,175,300
Detyrime të tjera	(30,546,824)	12,156,336
Rezervat e primit të pafiturar	118,857,076	218,421,949
Rezervat teknike për dëmet	159,772,804	58,201,693
<b>Fluksi monetar gjeneruar nga veprimtaria operative</b>	<b>278,075,515</b>	<b>318,898,303</b>
Tatimi fitimi i paguar	(21,207,537)	(39,412,310)
Interesi i paguar	(3,665,652)	(2,858,783)
Interesi i arkëtuar	17,949,679	14,087,828
<b>Fluksi monetar neto i gjeneruar nga veprimtaria operative</b>	<b>(6,923,510)</b>	<b>(28,183,265)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese:</b>		
Shitja e aksioneve në filial	399,069,464	-
Blerje të aktiveve afat-gjata materiale	(288,905,807)	(159,869,144)
Blerje të aktiveve afat-gjata jo materiale	-	(2,138,856)
Shitje e aktiveve afat-gjata materiale	15,405,448	-
(Rënia )/Rritja e borxhit te varuar në filial	-	1,152,500
Rritja / (Rënia) në investime	(377,838,391)	(122,207,255)
<b>Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaria investuese</b>	<b>(252,269,286)</b>	<b>(283,062,755)</b>
<b>Fluksi monetare nga veprimtaritë e financimit</b>		
Dividendët paguar ndaj aksionarëve	-	-
<b>Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaritë e financimit</b>		
<b>Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe</b>	<b>18,882,720</b>	<b>7,652,283</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	37,168,812	29,516,529
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit</b> 11	<b>56,051,532</b>	<b>37,168,812</b>

*Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 5 deri ne faqen 42 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.*



Ernst & Young Certified Auditors  
Albania Branch  
NIUS: K61911012I  
Ibrahim Rugova Str.Sky  
Tower,6<sup>th</sup> floor  
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575  
ey.com

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve të ALB - SIGURACION sh.a.

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ALB - SIGURACION" sh.a. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për periudhën dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit të veçantë financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, të rezultetit të saj të veçantë financiar dhe të fluksit të veçantë të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Shoqëria.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e "ALB - SIGURACION sh.a.", përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**Raportet për agjensitë rregullatore - kërkesa e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë për marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike**

Në vijim të kërkesave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, ne kemi lexuar Skedulet Suplementare bashkëlidhur për "Aktivet në mbulimin e provigjioneve teknike," "Llogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit" dhe "Marzhin e aftësisë paguese" ("Skedulet Suplementare"). Skedulet Suplementare të përgatitura nga drejtimi, nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të bashkëlidhur. Informacioni financiar historik, i paraqitur në Skedulet Suplementare të përgatitura nga drejtimi, është i qëndrueshëm, në të gjitha aspektet materiale me informacionin financiar vjetor, pasqyruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017, përgatitur në përputhje me legjislacionin kombëtar të kontabilitetit, të aplikueshëm për shoqëritë e sigurimit në Shqipëri. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Skeduleve Suplementare, në përputhje me Ligjin nr. 52, "Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit," të datës 22 maj 2014.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri

Mario Vangjel  
Ekspert Kontabël i Regjistruar

*Ernst & Young Certified Auditors*

30 prill 2018  
Tiranë, Shqipëri



*Mario Vangjel*

Bazuar nr Rregulloren nr. 56, datë 28.04.2016 "Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit" Norma e likuiditetit të Kompanisë ALBSIG Sh.a për Vitin 2017, bazuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje është më i lartë ose i barabartë me 1 (një).

**ALB - SIGURACION sh.a.****Skedule Suplementare më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***1. Aktive në mbulim të provigjioneve teknike**

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe rregullores nr. 19 “Për aktivet në mbulim të provigjioneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve” aktivet në mbulim të rezervës teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Gjithashtu në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 96 datë 03 gusht 2008, ndryshuar me vendimin nr. 5 datë 7 janar 2009; shoqëritë e sigurimit nuk mund të investojnë më shumë në aktive dhe në rezerva teknike dhe matematikore se përqindjet si më poshtë. Aktivet që mbulojnë rezervën teknike për periudhën e fund vitit 31 dhjetor 2017:

**Provigjione teknike bruto****1,492,603,506**

		<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	
	<b>Kufiri i investimeve në raport me provigjonet</b>	<b>Kufiri i investimit në vlerë sipas rregullores</b>	<b>Aktivët në mbulimin e provigjioneve teknike</b>
<b>Aktivët në mbulim të rezervës teknike</b>			
Depozitat bankare (pa fondin e garancisë)	Pa limit	Pa limit	999,629,073
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	3% e totalit	44,778,105	44,778,105
Toka dhe ndërtesa	30% (10% secila)	447,781,051	200,549,458
Aktivët e risigurimit	25%	373,150,877	117,356,758
Obligacione	Pa limit	Pa limit	8,000,000
Interesi i përlllogaritur	5%	74,630,175	8,119,648
Të arkëtushme nga aktiviteti i sigurues, bruto	më pak se 90 ditë	Pa limit	90,430,324
Aktivët e trupëzuara përveç tokës dhe ndërtesës	5%	74,630,175	74,223,065
Depozita e Kartonit Jeshil për Byron e Sigurimit	Pa limit	Pa limit	42,504,115
<b>Totali</b>			<b><u>1,585,590,546</u></b>
<b>Norma e mbulimit</b>			<b>106,23%</b>

**ALB - SIGURACION sh.a.****Skedule Suplementare më 31 dhjetor 2017***(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***2. Marzhi i aftësisë paguese (vazhdim)**

Mazhi I aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 dhjetor 2017 përbëhet si më poshtë:

<b>Elementët e marzhit të aftësisë paguese</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<b>A: Kapitali bazë dhe kapitali shtesë (kapitalet e veta sipas pasivit të bilancit)</b>	<b><u>1,161,518,185</u></b>
Kapitali aksionar i paguar	879,460,000
Fitimi i akumuluar	282,058,185
<b>B: Elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit sipas nenit 79 të ligjit 52/2014</b>	<b><u>498,650,927</u></b>
Llogari të tregtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit	43,586,494
Të tjera llogari të tregtueshme tregtare (debitorë të tjerë)	129,909,263
Të tjera parapagime dhe të ardhura të llogaritura (tatim fitim i parapaguar)	21,207,537
Inventari	1,628,371
Investime në sipermarrje me interesa pjesëmarrëse	-
Aktivet Jo-materiale	4,583,553
Garancia e kartonit Jeshil	42,504,115
Obligacione	8,000,000
Element të tjere të zbritshëm sipas rregullores 87, neni 4.	247,231,594
<b>C: Kapitali (Aftësia paguese) A-B</b>	<b>662,867,258</b>
D: Kufiri minimal i aftësisë paguese sipas pikes 3 në nenit 80 të Ligjit Nr.52/2014	315,606,612
E: Fondi i Garancise sipas nenit 80 të Ligjit 52/2014	370,000,000
F: Niveli i kerkuar i aftësisë paguese sipas pikes 2 të nenit 80 të Ligjit Nr.52/2014	473,409,918
<b>G: Mbi (+) / nen (-) nivelin e kerkuar të Aftësisë Paguese (C - F)</b>	<b><u>189,457,340</u></b>
<b>H: Mjaftueshmeria e Kapitalit</b>	<b><u>I Mjaftueshem</u></b>




## 7.Objektivat strategjike dhe vjetore

### 7.1 Parimet kryesore per zhvillimet ekonomiko - financiare për vitin 2018

- Synimi për të qenë shoqëri lider në treg për cilësinë e shërbimit ndaj klientëve;
- Shërbime cilësore dhe në kohë për klientët individë dhe bizneset nëpërmjet ofrimit të produkteve cilësore të sigurimit ekzistuese dhe të reja dhe pagesa shumë e shpejtë e dëmeve;
- Ruajtja e standarteve të larta në përzgjedhjen e personelit që merret me marrjen në sigurim, shitjen dhe e ndërmjetësave në sigurime;
- Shtimi i gamës së produkteve të reja sipas kushteve të tregut dhe kërkesave të klientëve;
- Mbajtja e një minimumi të raportit të aftësisë paguese ndaj nivelit minimal të kërkuar prej 250% për të krijuar aftësi absorbuese ndaj luhatjes së rezultatve;
- Synimi për mbajtjen e ROE minimum 10% ndaj kapitalit të vlerësuar sipas SNRF.

### 7.2 Objektivat kryesore për 2018 të përmbledhura si më poshtë:

- Forcimi i kuadrit të administrimit të rreziqeve;
- Rritja e volumit të primeve të shkruara bruto me 13% , por jo më pak se rritja e tregut;
- Përmirësimi i raportit të produkteve vullnetare;
- Pagesa e shpejtë e dëmeve;
- Arritja e një pozicioni të qëndrueshëm në tregun e sigurimeve.
- Përmirësimi i imazhit dhe standarteve



- Degjet (Branches)**
- SHKODER
  - LEZHE
  - DURRËS 1 & 2
  - TIRANË
  - KAVAJË
  - LUSHNJË
  - FIËR
  - SARANIDË
  - BERAT
  - KUKËS
  - PESHKOPI
  - POGRADEC
  - KORÇË
  - GJIROKASTËR
  - VLORE
  - SARANIDË
  - ELBASAN



**PJESË E  
KASTRATI**  
GROUP



# Sigurimi Kasko



**PJESË E  
KASTRATI**  
GROUP



**PËRFITONI KONTROLL DENTAR,  
IMAZHERIK, SHËRBIME MJEKËSORE  
NË RAST AKSIDENTI  
APO SËMUNDJESH AKUTE**



**Sigurim Shëndeti  
me Kartën Superior**



**PJESË E  
KASTRATI**  
GROUP



**Sigurimi familjar  
i shëndetit në udhëtim**



**PJESË E  
KASTRATI**  
GROUP



# Sigurimi i Parave në Udhëtim



**PJESË E  
KASTRATI**  
GROUP



# Aksidentet Personale



**PJESË E  
KASTRATI**  
GROUP

## Siguro veten, Siguro familjen



**Sigurimi familjar  
i shëndetit në udhëtim**





**PJESË E  
KASTRATI**  
GROUP



# Sigurimi i garancisë së kontratës



*PJESË E*  
**KASTRATI GROUP**

---

**Adresa**

**ALBSIG sh.a**  
Rruga "George W. Bush", Nr. 10,  
Tirana, Albania



**Telefon & Fax**

Tel: +355 422 54 764  
Cel: +355 68 20 52 744



**Online**

Email: [info@albsig.al](mailto:info@albsig.al)  
Website: [www.albsig.al](http://www.albsig.al)

---